



ZHVILLIMI I TË MENDUARIT KRITIK DHE KRIJUES TE NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLOREⁱ

Merita Banjicaⁱⁱ

South East European University (UEJL),
Tetovo, North Macedonia

Abstrakt:

Ky punim pasqyron teorinë konstruktiviste të zbatuar në praktikën e mësimdhënies dhe strategjinë e mësimdhënies konstruktiviste për të shkruarit e krijimeve e transferuar në teori shkencore pedagogjike-didaktike për mësimdhënien konstruktiviste. Në fakt, punimi merr karakter të një mjeti ndihmës, që mund t'u shërbejë mësimdhënësve për mësimdhënien konstruktiviste gjatë orëve të fushës "Të shprehurit dhe krijimtaria" për të shkruarit të ndonjë krijimi, por bëhet edhe mjet ndihmës për nxënësit e shkollave fillore, që mund t'u shërbejë si mjet orientues për të shkruarit krijimeve individuale. Punimi publikohet qëllimisht për t'i stimuluar nxënësit të lexojnë sa më tepër libra dhe për t'i zhvillojnë shkathtësitë e të shkruarit duke krijuar krijime të ndryshme në vazhdimësi.

Qëllimi i hulumtimit: Qëllimi i këtij hulumtimi u përqendrua në tri objektiva:

Të ofrojë sqarime teorike për konceptet e mësimdhënies konstruktiviste për zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve për të shkruarit e krijimeve të ndryshme;

Të pasqyrojë metodologjinë e hulumtimit në SH.F.K "Ismail Qemali"-Gostivar, RMV; Të pasqyrojë disa nga krijimet e nxënësve të krijuara me orientim të mësimdhënies konstruktiviste. Të pasqyrojë edhe përfundimin i këtij hulumtimi.

Metodat e hulumtimit: Në këtë hulumtim teorik-empirik u përdor metoda e analizës teorike pedagogjike-didaktike dhe gjuhësore, metoda empirike eksperimentale-aplikative aksionale "ex post facto", metoda përshkruese, metoda e analizës, metoda e vëzhgimit. Mostra e këtij hulumtimi u përqendrua në instrumentet hulumtuese-krijimet, që u bënë si rezultat i mësimdhënies konstruktiviste.

Fjalët kyçe: mësimdhënie konstruktiviste, parimet e konstruktivizmit, strategjia konstruktiviste

ⁱ DEVELOPMENT OF CRITICAL AND CREATIVE THINKING IN PRIMARY SCHOOL STUDENTS

ⁱⁱ Correspondence: email meritabanjica@yahoo.com

Abstract:

This paper reflects the constructivist theory applied in teaching practice and the constructivist teaching strategy for writing creative works transferred to the scientific pedagogical-didactic theory for constructivist teaching. In fact, the paper takes on the character of an auxiliary tool, which can serve teachers for constructivist teaching during classes in the field of "Expression and Creativity" for writing a creative work, but it also becomes an auxiliary tool for elementary school students, which can serve as an orientation tool for writing individual creative works. The paper is published intentionally to stimulate students to read as many books as possible and to develop their writing skills by continuously creating different creative works.

Research purpose: The purpose of this research focused on three objectives: To provide theoretical explanations for the concepts of constructivist teaching for the development of critical and creative thinking of students for writing various creations; To reflect the research methodology at the "Ismail Qemali" Primary School-Gostivar, RMV; To reflect some of the students' creations created with a constructivist teaching orientation. To also reflect the conclusion of this research.

Research methods: In this theoretical-empirical research, the method of theoretical pedagogical-didactic and linguistic analysis was used, the empirical experimental-applicative action method "ex post facto", the descriptive method, the analysis method, the observation method. The sample of this research focused in research instruments - creations, that were made as a result of constructivist teaching.

Keywords: constructivist teaching, principles of constructivism, constructivist strategy

I-Pjesa Teorike

1. Hyrja

Mësimdhënia e shekullit XXI për të shkruarit e krijimeve kërkon planifikim, organizim, zbatim dhe vlerësim të mësimdhënies, ku në qendër të vëmendjes është nxitja e të menduarit kritik dhe krijues të nxënësit përmes përdorimit të strategjisë së mësimdhënies konstruktiviste. Të shkruarit e krijimeve të nxënësit nxitet prej në klasat e ulëta, por kjo përvetësohet më tepër te klasat VI, VII, VIII, IX. Çdo nxënës për ta nxitur të menduarit kritik çdoherë i rikujton njohuritë nga përvojat e mëparshme për të shkruarit dhe mëson diçka të re, që duhet ta shpreh në krijimin e ri.

Mësimdhënia konstruktiviste për të shkruarit është proces i të shkruarit me nxënie, ku nxënësi nxitet në aktivitet mësimor me teknologji mësimore (metoda, teknika dhe mjeteve mësimore) me aktivizimin e të menduarit krijues, të menduarit kritik dhe të menduarit e zgjidhjes së problemeve për të gjeneruar një produkt të ri-krijim me reflektimin e vullnetit për të shkruar, me përdorimin e njohurive të mëparshme, rikujtimin e përvojave të proceseve së të shkruarit dhe shprehjen e përvojave individuale. Libri është strukturuar në tri pjesë:

- Në kapitullin e parë ofrohen shqyrtimet teorike për mësimdhënien konstruktiviste për zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për të shkruarit e krijimeve të ndryshme u mbështet në teoritë e shkencëtarëve nga fusha e pedagogjisë, didaktikës dhe gjuhës.
- Në kapitullin e dytë është pasqyruar metodologjia e hulumtimit.
- Në kapitullin e tretë është pasqyruar hulumtimi empirik aksional i zhvilluar me nxënësit, me të cilët punoj gati katër vite, ku gjatë orëve të gjuhës nxënësit nxiteshin t'i zhvillojnë edhe shkathtësitë e të shkruarit. Pasqyrohen disa punime të nxënësve, që janë krijuar për raste të ndryshme sipas zhvillimit gradual të tyre. Përfundimi pasqyrohet në fund të librit.

1.1 Mësimdhënia Konstruktiviste

Mësimdhënia konstruktiviste në teorinë e Xhon Djuit shpjegohet se *“Edukimi progresiv thjesht është një shkollë mendimi, që thekson rëndësinë e të përqendruarit te motivimi i nxitjes së të menduarit krijues, të perceptimit vizual dhe të rezultateve të përvojave të mëparshme, ku përgjigja modulohet nga përvoja dhe përjetimet.”* (M.A. Selver, 2019ⁱⁱⁱ; Djui, 1904 shih: Musai, B 2003:201)^{iv}. Kjo teori është mbështetur në teoritë e Piazhësë, Viogotskit, Brunerit, që përqendrohen në rolin aktiv të nxënësit në ndërtimin e të kuptuarit, rikujtimin e përvojës dhe përjetimeve në lidhshmëri me informatën e re, që e merr për të krijuar një kuptim të ri.

Teoritë konstruktiviste pajtohen në dy ide:

- nxënësit të jenë aktiv në ndërtimin e dijeve të tyre.
- nxënësit ta dinë se në këtë proces të ndërtimit të dijeve kanë rëndësi ndërveprimet sociale.

Mësimet me bazë konstruktivise hartohen me synimin për të nxitur nxënësit të përdorin përvojat e tyre dhe në mënyrë aktive të ndërtojnë të kuptuarit në një produkt të ri e jo të kërkojnë të kuptuarit sipas modelit e ndërtuar nga mësimdhënësi i tyre. (Musai, B, 2003 f. 201)^v. Dijet burojnë nga ndërtimi individual i realitetit, sipas këndvështrimit individual të çdonjërit, që ndodh atëherë kur nxënësi krijon rregulla dhe hipoteza të reja për ta shpjeguar atë që vëzhgon.

Nevoja për të rikujtuar rregulla të reja dhe për të formuluar hipoteza nxitet nga dialogu në klasë, zgjidhja e problemit, ushtrimet dhe detyrat individuale me karakter hulumtues, që nxjerrin në pah ndryshime dhe dallime midis njohurive të mëparshme *“të vjetra”* dhe atyre që i vëzhgojnë dhe i perceptojnë. Mësimdhënësit përdorin përvojën e drejtpërdrejt (Piaget, 1997), të nxënët e bazuar në projekte (Blomenfeld dhe të tjerët, 1991) dhe ndërveprimet sociale.

R. E. Mayer (1987) studiuese e fushës së kognitive ka dalluar tri kushte themelore për të nxënët e kuptimshëm: Marrja, disponueshmëria dhe aktivizimi, që arrihen atëherë

ⁱⁱⁱ M. A. Selver Bajgora (2019). Fushat e të nxënët; <https://selverbajgora.weebly.com/artikuj-pedagogjik/fushat-e-te-nxenit>

^{iv} https://sq.wikipedia.org/wiki/John_Dewey

^v Musai, Bardhyl (2014). Metodologji e mësimdhënies –Arti dhe shkencë të përgatitur nga nxënës të suskeshëm, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Botimi i dytë ISBN: 978-99927-822-2-6, Tiranë.

kur mësimdhënësi e përqendron vëmendjen e nxënësve në një problem. Mësimdhënësi i plotëson kushtet e aktivizimit të plotë përmes modelimit të procesit, të shqyrtimit, të hetimit dhe teknikave të zotëruara me mjeshtri për të pyeturit dhe për përgjigjet. Nxënësit sa më shumë shprehi fitojnë në shqyrtim, hetim dhe zgjidhje të problemit, më pak bëhet mbështetja e mësimdhënësit duke i lejuar ata të marrin më tepër përgjegjësi për të nxënësit e tyre (Musai, B, 2003 f. 200).

Këndvështrimi i Moshman (1982) për mënyrën e ndërtimit të dijeve paraqitet me tri shpjegime:

- Ndërtimin e dijeve të individit e drejtojnë realitetet dhe të vërtetat e botës së jashtme duke ndërtuar përfytyrime mendore të sakta si *rrjete premisash, koncepte, lidhje shkak-pasojë* dhe *rregulla kusht-veprim* që pasqyrojnë mënyrën “*se si janë gjërat në realitet*”. Njeriu sa më shumë të mësojë, aq më e thellë dhe më e gjërë është përvoja e tij, që në fakt njohuria e atij njeriu e pasqyron realitetin objektiv. Pikëpamja mbi ndërtimin e dijeve të individit mbështetet te përpunimi i informatave, të qëndrueshme në kujtesë (përvoja), që stimulohen nga faktorë të real të botës së jashtme (temave) për të krijuar krijim të ri.
- Ndërtimin e dijeve e ndërtojnë proceset e brendshme si organizimi, përvetësimi dhe përshtatja (Piazhe, 1997). Dijet e reja abstraktohen prej njohurive e vjetra. Dijet nuk janë pasqyrë e realitetit, por janë pak a shumë një abstragim, që rritet dhe zhvillohet me aktivitetin kognitiv. Dijet nuk janë të vërteta ose të rreme, por ato thjeshtë rriten më shumë në mënyrë konsekuente dhe të organizuara nga zhvillimi.
- Ndërtimin i dijeve e drejtojnë si faktori i jashtëm ashtu edhe faktorët e brendshëm. Dijet rriten përmes ndërveprimit të faktorëve të brendshëm (kognitivë) si dhe nga faktorët e jashtëm (mjedisorë dhe shoqërorë). Vigotski zhvillimin kognitiv të njeriut e shpjegon si ndërtim i dijeve të individit me përvetësimin e përdorimit të mjeteve kulturore me gjuhën. Banduras thotë se ndërtimi i dijeve arrihet me ndërveprimet e ndërsjella midis njerëzve, sjelljeve dhe mjedisëve (Woolfolk, A 2011:313^{vi}; Musai, B 2014 f.201^{vii}).

Teoritë konstruktiviste nxënësin e vënë në qendër të vëmendjes me të vepruarit në klasë, prandaj klima në klasë duhet të jetë e kënaqshme, që nxënësi të nxitet:

- me vullnet t'i qaset të shkruarit për të gjeneruar krijim të ri,
- t'i përdor dijet nga përvojat për të lidhur gjeneruar krijim të ri sipas informatës së re,
- të parashtrojë pyetje divergjente për t'i rikujtuar njohuritë e integruara në kujtesë për t'i sqaruar fjalët kyçe,
- t'i bashkërendit fjalët në fjali dhe paragrafë për ta krijuar kornizën tematike pragmatike
- ta korrigjojë krijimin disa herë,

^{vi} Woolfolk, Anita (2011). Psikologji edukimi-Universiteti Shtetëror i Ohajës, Botuar nga Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.

^{vii} Musai, Bardhyl (2014). Metodologji e mësimdhënies –Arti dhe shkenca të përgatitur nga nxënës të suskeshëm, Qendra për Arsim Demokratik(CDE), Botimi i dytë ISBN: 978-99927-822-2-6, Tiranë.

- ta riformulojë krijimin disa herë,
- ta vetëvlerësojë krijimin e vet duke e lexuar me zë,
- ta vetëvlerësojë krijimin e vet duke e krahasuar me krijimin e lexuar të dikujt tjetër,
- ta prezantoj krijimin para të tjerëve në klasë ose para dikujt tjetër.

Klima e kënaqshme dhe pozitive për të shkruarit në klasë ëshë në varshmëri nga sjellja e mësimdhënësit, nga përdorimi i informatave kthyesë (feedback) të tij gjatë bashkëbisedimit, që e nxisin nxënësin në sjellje krijuese pozitive (motivim) dhe negative (demotivim) (Matwes, 2003 shih: Temple, Ch dhe të tjerët, 2006:6; Zajazi, 2003:448).

Tabela 1: Përdorimi i shprehjeve pozitive (motivuese) dhe negative (demotivuese) të mësimdhënësit për ta krijuar klimën e kënaqshme ose të pakënaqshme në klasë

Përkrahje negative	Përkrahje pozitive
<i>Çfarë mendimi të palogjikshëm shprehe?</i>	<i>Të lumtë, shumë mendim i mirë dhe interesant!</i>
<i>Ndalu, mos shpreh mendime pa lidhje!</i>	<i>Të lutem, më trego ndonjë mendim tjetër për...!</i>
<i>Hesht se asgjë nuk na tregove!</i>	<i>Çfarë mendimi tjetër ke ti Sara?</i>
<i>Hesht, kurr gjë nuk tregove! A kaq di për këtë!</i>	<i>Çfarë mund t'i shtosh këtij mendimi Diar? Shprehu!</i>
<i>Turp asnjëri nuk shtoi asgjë.</i>	<i>Kush mund ta formuloj mendimin e Sarës ndryshe?</i>
<i>Çudi, asnjëri nuk ka mendim tjetër?!</i>	<i>Kush pajtohet me mendimin e Sarës? Pse pajtoheni?</i>
<i>Përse jeni kundër këtij mendimi të mirë?</i>	<i>Kush është kundër mendimit të Sarës? Pse jeni kundër?</i>
<i>Përse nuk përgjigjeni, a nuk dini të mendoni?!</i>	<i>Sara, pyete Diarin a ka t'i shtojë diçka përgjigjes sate?</i>
<i>A nuk mund të mendoni ndryshe?</i>	<i>Si do të përgjigjeshe ndryshe nëse?</i>
<i>Si nuk thae një gjë të mirë dhe të saktë!</i>	<i>Si arrite në këtë përfundim? Si e gjete atë përgjigje?</i>
<i>Rri urtë, sillu mirë dhe shprehu mirë!</i>	<i>A ka dallim përgjigja e Diarit me përgjigjen e Sarës?</i>
<i>Ulu, aspak ky mendim nuk i ngjan mendimit të Sarës!</i>	<i>A ka ngjajshmëri përgjigja e Diarit me përgjigjen e Sarës?</i>
<i>Ulu, aspak nuk është mendim interesant!</i>	<i>Ja, një ide interesante?!</i>
<i>Ulu, aspak nuk vlen të përziehen të dy mendimet!</i>	<i>Po sikur të kombinohet mendimi i Sarës me të Diarit?!</i>
<i>Ti mendoje se është lehtë të shprehësh ide të qëlluara?!</i>	<i>A ke menduar për alternativa të reja?</i>

1.2 Parimet e konstruktivizmit

Konstruktivizmi është mësimdhënia e orientuar drejt nxënësit, prandaj mjedisi i të mësuarit duhet të mundësojë pikëpamje ose interpretime të ndryshme të realitetit, konstruktim të diturisë, pasuri të përmbajtjeve dhe aktivitete që bazohen në përvojë. Konstruktivizmi bazohet në dituritë, e jo në përsëritjen e diturive. Personi e krijon diturinë e tij në bazë të përvojës së tij, strukturave mendore dhe besimeve që përdoren për interpretimin e objekteve dhe ngjarjeve.

Mendja përdoret si instrument në interpretimin e ngjarjeve, qëllimeve, perspektivave se ato janë individuale dhe personale. Pikëpamja ndaj botës dallon te çdonjëri për shkak të përvojave personale dhe individuale. Arsimimi i fëmijës të përqendrohet në detyrat autentike, që kanë vlerë dhe dobi në botën e vërtetë ose që burojnë nga realiteti, ndërsa janë të integruara në planin dhe programin mësimor, me çka u mundësojmë pjesëmarrje të caktuar të nxënësi sipas Bruner, X. dhe Vigotski^{viii}. (shih: Doracak për arsimtarët e arsimit fillorë, 2009:78).

^{viii} Doracak për arsimtarët e arsimit fillorë (2009) Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21, Projekt i Arsimit Fillor, USAID- AED and Colaboration Partner ISBN 978-608-65040-1-4, Shkup.

Në klasën konstruktiviste mësimdhënësi është orientues i nxënësve, ai siguron zhvendosje dhe mbindërtim, ndihmon në rritjen e hapësirës së zhvillimit të parashikuar të diturive. Nxënësi është i inkurajuar që të zhvillojë shkathtësitë metakognitive, siç është të menduarit reflektiv dhe metodat e zgjidhjes së problemeve. Nxënësi i pavarur është i lirë të gjenerojë, të zbulojë, të ndërtojë dhe ta rrisë kufirin e diturisë së tij (shih Doracaku: 2009:78)^{ix}.

Dhjetë parimet themelore të mendimit konstruktivist, që arsimtarët dhe nxënësit duhet t'i dinë:

- Nevojitet kohë për mësim, mësimi nuk është momental, por nevojitet kohë për mësim duke u kthyer në idetë e vjetra për të eksperimentuar me ata, për t'i studiuar dhe për t'i përdorur, kurse kjo nuk ndodh për 5 ose 10 minuta, por disa ditë, muaj e vite (përvojë).
- Njerëzit mësojnë si të mësojnë. Mësimi përbëhet edhe nga gjetja e kuptimit të asaj, që mësohet, por edhe nga konstruktimi i sistemit/strukturës së diturisë. Secilin kuptim që e gjejmë na mundëson të gjejmë kuptim më të mirë të ngjarjeve të tjera që mund të përshtaten në ato korniza.
- Në procesin e të mësuarit është inkuadruar gjuha, që e përdorim se ndikon në të mësuarit. Në kur mësojmë, flasim me veten tonë, gjuha dhe mësimi janë një tërësi unike e pandarë.
- Mësimi është i lidhur me kontekstin (përmbajtjen). Në nuk mësojmë varësisht nga ajo, që tani e dimë, nga ajo që tani besojmë, në raport me paragjykimet dhe drojat tona.
- Mësimi nuk është pranim pasiv i diturisë që ekziston "atje diku". Mësimi nënkupton se ai që mëson duhet të jetë pjesë e botës dhe të nxjerrë përfundime në bazë të përvojës së tij.
- Mësimi është proces aktiv, ku nxënësi përdor shqisën u jep kuptim informatave të pranuar. Nxënësit kanë nevojë të bëjnë diçka sepse mësimi i inkuadron në atë që ndodh në botë.
- Dhënia kuptim gjërave është proces mendor, që ndodh në mendje. Neve na duhen aktivitete që do ta angazhojnë mendjen dhe duart.
- Mësimi është aktivitet social, që është i lidhur me lidhjen që ne e kemi me të tjerët, me arsimtarët tanë, me moshatarët dhe me familjen. Bisedat dhe ndërveprimi me të tjerët janë pjesë integrale e mësimi.
- Nevojitet dituri që të mësohet. Nuk ka mundësi të përvetësohet një dituri e re pa pasur një strukturë të zhvilluar paraprake nga mësimi i mëparshëm. Sa shumë që dimë, aq më shumë mund të mësojmë.
- Motivacioni është komponentë kryesor në mësim, është baza që ndihmon në mësim.

^{ix} Doracak për arsimtarët e arsimit fillorë (2009) Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21, Projekt i Arsimit Fillor, USAID- AED and Colaboration Partner ISBN 978-608-65040-1-4, Shkup.

Konstruktivizmi është në theb një teori e bazuar në vëzhgimin dhe studimin shkencor rreth së mënyrës se si njerëzit mësojnë duke i kombinonë njohuritë e tyre ekzistuese me informata të reja, për të ndërtuar kuptimin dhe për të formuluar të kuptuarit e tyre përmes përjetimit të gjërave dhe reflektimit mbi këto përvoja (Habibi, B 2018)^x.

1.3 Strategjia e mësimdhënies konstruktiviste për të shkruarit

Strategjia e mësimdhënies për të shkruarit e një krijimi, nxënësit i nxit në rikujtim të përvojave të mëparshme duke i lidhur me informatën e re për të riprodhuar një krijim të ri efektiv dhe pragmatik në drejtim të kuptimit të plotë nga ana e lexuesve. Çdo nxënës mund të bëhet edhe shkrimtar i mirë, prandaj duhet t'i mësohen strategjitë e të shkruarit se si të shkruaj diçka të re dhe interesante për lexuesit e vet. (Banjica, M 2020)^{xi}.

Çdo nxënës në momentin e parë të fillimit të procesit për të shkruarit, kur njoftohet me titullin e temës së caktuar për krijim, fillon nxitja e shprehjes së qëndrimit pozitiv për gatishmërinë e tij për të pranuar të angazhohet për ta krijuar temën ose për të mos pranuar të angazhohet për ta krijuar temën. Çdo nxënës duke shkruar ushtron dhe krijon përvojë krijuese për të shkruarit e çdo krijimi, që i ndihmon si strategji për të krijuarit të një krijimi të ri. Kjo reflektohet me reagime:

- Pranimi i strategjive nga mësimdhënësi për procesin e të shkruarit.
- Përvetësimi i njohurive për zhvillimin e procesit së të shkruarit nga nxënësi.
- Zbatimi i teknologjisë mësimore për të shkruarit gjatë procesit të krijimit.
- Zhvillimi i shkathtësive të krijimtarisë duke krijuar përvojë krijuese (krijime).
- Vetëvlerësimi i krijimit si një vlerë individuale-shoqërore.

1.4 Nxitja e të menduarit krijues

Mësimdhënia për të shkruarit nxitet me aktivizimin e tri fushave të Taksonomisë së Bloom-it (1995), të Taksonomisë Krathwoln (1964) dhe të Taksonomisë Harowit (1972):

1. Fushës kognitive merret me studimin e objektivave të përsëritjes së njohurive ose dijeve si dhe me zhvillimin e aftësive dhe shprehive intelektuale. Fusha konjitive ose Taksonomia Bloom-it (1995), ka pësuar disa ndryshime pas rishikimit të bërë nga një ish-studentët e Bloomit, Anderson dhe Sosiak (2001) me synim për t'i përmbushur nevojat e nxënësve dhe mësimdhënësve të shekullit XXI në përshtatshmëri me kërkesat e shoqërisë së dijes duke e shndërruar masat njëpërmasore (proceset e njohëse të niveleve me emra të shndërruara në folje), me ndryshime dypërmbajtësore në :

- Terminologji, ku emrat janë shndërruar në folje (njohja-kujto, kuptimi- kupto, zbatimi-zbato, analiza-analizo, vlerësimi-vlerëso, krijimi-krijo).

^x Habibi, Bora (2018). Konstruktivizmi në edukim parë më 21.04.2025 në: https://www.academia.edu/40467297/KONSTRUKTIVIZMI_N%C3%8B_EDU

^{xi} Banjica, Merita (2020). The approach on teaching writing a creation-essay (Qasja në mësimdhënien e të shkruarit të një krijimi-ese) botuar në Knowledge, International Journal, Vol. 42.

- Strukturë, ku ka ndryshime të radhitjes sipas katër niveleve, ku proceset njohëse përdoren në të nxënit si: faktike, konceptuale, procedurale dhe meta-kognitive. Proceset janë të radhitura në 6 nivele si folje: kujto, kupto, zbato, analizo, vlerëso, krijo.

Fusha kognitive ose Taksonomia e Blomit (1995) dhe nivelet e saj sipas rishikimit të Anderson dhe Sosiak (2001) dhe shembujt përkatës të përdorimit të foljeve:

- Njohja-Mbani mend: caktoni, përcaktoni, duplikoni, etiketoni, listoni, memorizoni, emërtoni, renditni, njihni, lidhni, kujtoni, përsëritni, riprodhoni, deklaroni !
- Kuptimi-Kuptoni: klasifikoni, përshkruani, diskutoni, shpjegoni, shprehni, identifikoni, tregoni, gjeni, njihni, raportoni, rishkruani, shqyrtoni, zgjidhni, përktheni !
- Zbatimi-Aplikoni: aplikoni, zgjidhni, demonstroi, dramatizoni, punësoni, ilustroni, interpretoni, veproni, praktikoni, planifikoni, skiconi, zgjidhni, përdorni, shkruani!
- Analizim-Analizoni: analizoni, vlerësoni, llogarisni, kategorizoni, krahasoni, kontraste, kritikoni, diferenconi, dalloni diskriminimin, ekzaminoni, eksperimentoni, pyetni, testoni!
- Vlerësimi-Vlerësoni: vlerësoni, argumentoni, bashkëngjitni, zgjidhni, krahasoni, mbron vlerësimin, gjykoni, parashikoni, përsëri vlerësoni, zgjidhni, mbështetni, përsëri vlerësoni!
- Krijimi (Sinteza)-Krijoni: organizoni, mblidhni, grumbulloni, kompozoni, ndërtoni, krijoni, dizajnoni, zhvillon, formuloni, menaxhoni, organizoni, planifikoni, përgatitni, propozoni, ngini, shkruani. (Imeraj, V. 2024; Lewis, 2020)^{xii}.

Fusha afektive ose Taksonomia Krathwoln (1964) studion qëndrimet, bindjet, spektrin dhe sistemin e vlerave. Kjo është fusha e dytë e zhvillimit emocional, që përfshin efekte dhe vlera të brendshme psikologjike të njeriut (emocionet, ndjenjat, qëndrimet, vlerat (Zajazi, 2023:240; Seels dhe Glasgow, 1990:28).

Kategoritë e fushës afektive janë:

1. Marrja (Pranimi) shprehet me gatishmërinë e nxënësve për të qenë të sinqertë ndaj mesazheve që i ofron mjedisi. Kjo fazë kalon në tri nënndarje:

- Vetëdija: Nxënësi është në dijeni për atë që ndodh, është i vetëdijshëm dhe i zgjuar për atë ide ose mesazh që ofrohet.
- Gatishmëria është hapi i dytë i nivelit të marrjes, që demonstroi dëshirën e nxënësit për pranimin e mesazhit me reagim pozitiv “po” ose reagim negativ “jo”.
- Vëmendja e zgjedhur është hapi i tretë që reflektohet me përqendrimin e vëmendjes së nxënësit në njërin nga stimujt e jashtëm.

2. Përgjigja (Reagimi) shprehet me disponim të nxënësit për të marrë qëndrim me tendencë pozitive për t’u përgjigjur. Kjo fazë ka tri nënndarje:

^{xii} Valbona, Imeraj (Taksonomia e rishikuar e Bloom-it pare më 12.04.2025 në: https://www.academia.edu/11234134/Taksonomia_e_rishikuar_e_BLOOM_it

- Pranimi në heshtje, kur nxënësi vepron në përputhje me traditat, rregullat, normat e trashëguara nga mjedisi i lindjes.
- Gatishmëria shprehet kur nxënësi vepron dhe i di arsyet. Gatishmëria nxënësit i ndihmon të merr vendim të reagojë dhe të përgjigjet.
- Kënaqësia në përgjigje, nxënësi pasi merr vendim të përgjigjet ndjen një kënaqësi emocionale.

3. Vlerësimi shprehet te nxënësi si një sjellje subjektive, e motivuar nga këndi ashtu si ka fituar bindje ai ndaj ndonjë vlere. Kjo fazë kalon në tri nënndarje:

- Pranimi i një vlere si e dobishme për të dhe për të tjerët.
- Preferenca ndaj një vlere, identifikohet ose demonstroi preferencë ndaj asaj vlere.
- Kryerja është akti i arritjes së demonstrimit të vlerës, angazhimi i brendshëm emocional i nxënësit me preferencë nga një vlere, që e drejton edhe sjelljen e tij.

4. Organizimi shprehet te nxënësi si rrjedhojë e përvojës kur ai është në gjendje të demonstrojë renditjen e vlerave emotive. Kjo fazë kalon në dy nënndarje:

- Renditja e vlerave sipas lidhjeve demonstroi, kur nxënësi arrin të përcaktojë lidhje të vlerave me njëra-tjetrën në një kornizë abstrakte.
- Organizimi i një sistemi të vlerave lidhet demonstrimin e zbatimit të veprimit.

5. Eksteriorizimi i vlerës demonstroi se nxënësi vepron ose sillet në përputhje me vlera të brendshme në të cilat ai beson. Ky nivel ka dy faza:

- Qëndrimi është shprehja e pëlqimit të individit ndaj një vlere: humane, tradite, sjelljeje, karakteri, etike, empatike, patriotike, sociale, morale, së cilës ai i beson.
- Eksteriorizimi demonstroi me pronësimin e një vlere, që bëhet pjesë e kulturës së tij. (M.A. Selver Bajgora (2019); Zajazi, 2003:246 ; Seels& Glasgow, 1990:28)^{xiii}.

Fusha psiko-motore ose Taksonomia Harowit (1972) përfshin aspektet e lëvizjes fizike dhe bashkërendimit, kombinimi i elementeve perceptuese dhe realizimi i detyrave të përcaktuara. Taksonomia e Harowit ka 6 nivele :

- Lëvizje të mbështetura në reflekte (aftësi të lindura).
- Lëvizjet themelore, ndjekja vizuale e një sendi, zvarritja, ecja dhe rrëmbimi i sendit.
- Aftësi perceptuale, vetëdija e njeriut, diferencimi i figurës bazë, reagimi i auditorit, kujtesa.
- Aftësitë fizike, zgjatja muskulare, shkathtësia, forca.
- Lëvizje e aftësuar, shprehitë e thjeshta të përsëritura disa herë duke krijuar përvojë pune si: të shkruarit e esejave, të ankesave, njoftimeve, ftesave, loja, loja në role etj.
- Komunikimi i përqendruar në një temë, demonstrim të roleve, interpretim të një njoftimi të ri me përdorim të lëvizjeve trupore për të qenë më të bindshëm, përdorimi i trurit për të krijuar ndonjë krijim, ku shprehen mendime dhe emocione të përjetuara. (M.A. Selver Bajgora (2019); Zajazi, 2003:254).

^{xiii} M.A. Selver Bajgora (2019). Fushat e të nxënit <https://selverbajgora.weebly.com/artikuj-pedagogjik/fushat-e-te-nxenit>

Angazhimin i tri taksonomive për zhvillimin e të menduarit krijues për të shkruar një krijim paraqitet në faqen në vijim me një grafik në Figurën.2.




Figura 1: Organizues grafik hierarkik për të menduarit kritik, ku angazhohen të tri fushat e të menduarit: Fusha kognitive (Taksonomia e Bloomit, 1995 e rishikuar nga Anderson dhe Lorin, 2001 Fusha afektive (Taksonomia e Krathwoln, 1964) dhe Fusha psiko-motore (Taksonomia e Harowit, 1972).

Përballja me informatën e re nxënësin e nxit të bëjë pyetje për të shprehur ide, të bëjë pyetje për t'i rikujtuar përvojat dhe përjetimet, të bëjë pyetje si të gjenerojë një produkt të ri, krijim. Çdo nxënës është krijues aktiv i dijeve të tij, prandaj duhet t'u bëjë pyetje njohurive ekzistuese, t'i analizojë, t'i vlerësojë, t'i përzgjedh dhe t'i sintetizojë në krijim të ri.

Çdo nxënës duke krijuar krijim të ri mëson njohuri të reja, krijon dije afatgjate, kurse duke dëgjuar njohuri vetëm nga mësimdhënësi mëson njohuri me kujtesë afatshkurte. Çdo nxënës është i ndyshëm dhe i veçantë, prandaj edhe nevojitet mësimi konstruktivist se secili mësimin e mëson dhe kupton ndryshe duke i ndërtuar dijet sipas vetëkuptimit së botës ku jeton, si vepron, si mendon (ide), si punon, si përjeton dhe si gjykon.

Mësimi me mësimdhënie konstruktiviste është marrëdhënia interaktive midis nxënësit, detyrave dhe mësuesit, që vepron si lehtësues të nxënës për zbulimin i njohurive të reja nga vet nxënësit. Parimet konstruktiviste nëse zbatohen në arsim, nxënësit do të mësojnë më lehtësisht dhe me më efikasitet të madh, që do të në zhvillimin e secilit për të ndikuar edhe në zhvillimin e shoqërisë.

2. Pjesa E Dytë - Metodologjia E Hulumtimit

2.1 Objekti i hulumtimit

Objekti i hulumtimit në këtë punim ishte zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues për të shkruarit e krijimit të nxënësve të shkollave fillore. Në shkollën fillore, ku jam duke punuar, tri vite vështroja punën e nxënësve gjatë orëve të krijimtarisë. Këto nxënës vazhdimisht u orientuan për të shkruarit e krijimeve gjatë orëve të gjuhës shqipe, ashtu që filluan të gjenerojnë krijime prgamtike për çdo temë të parashtruar. Gjatë këtyre orëve si orientim përdora strategji të ndryshme, që ato t'i mësojnë si të shkruajnë punime pragmatike (të kuptueshme nga lexuesi).

2.2 Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit i këtij hulumtimit teorik-empirik aplikativ aksional ishte përqendrimi në fushën e krijimtarisë së nxënësve për zhvillimin e shkathtësive të shkruarit të krijimeve të orientuar nga mësimdhënia konstruktiviste. Çdo mjeshtri zhvillohet në mënyrë graduale, ashtu edhe të krijuarit zhvillohet në mënyrë graduale përmes zbatimit të strategjive mësimore të mbështetura në përvojë:

- Objektiva e parë e këtij punimi është e përqendruar në sqarimin e koncepteve kyçe për mësimdhënien konstruktiviste dhe zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues për të krijuarit e krijimeve të ndryshme.
- Objektiva e dytë ishte përqendruar në mbledhjen e krijimeve të nxënësve.
- Objektiva e tretë ishte e përqendruar në pasqyrimin e krijimeve të nxënësve.
- Objektiva e katër u shfaq para "23 Prill-Ditën Ndërkombëtare të Librit", që ky punim të botohet si libër për t'iu dhuruan nga një libër autorëve të poezive dhe esejave për t'iu motivuar të vazhdojnë me të shkruarit e krijimeve duke e përdorur përvojën krijuese.

2.3 Hipoteza

Mësimdhënia konstruktiviste i ndihmon nxënësit më lehtë të krijojnë krijime duke përdorur strategji mësimore, me të cilat bëhet lidhshmëria e përvojës, përjetimeve dhe informatës e re.

2.4 Variabla

- **Variabla e varur:** Zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues të nxënësit për të krijuar krijime.
- **Variabla e pavarur:** Përdorimi i strategjisë konstruktiviste në orët e krijimtarisë të gjuhës shqipe.

2.5 Metodat e hulumtimit

Në këtë hulumtim pedagogjik-didaktik-gjuhësor u përdorën metoda teorike, metoda empirike aplikative aksionale "ex post facto", metoda përshkruese, metoda e analizës, metoda e vëzhgimit.

2.6 Instrumente hulumtuese

Në këtë hulumtim si instrumente hulumtuese u përdorën krijimet e nxënësve, kapitulli i tretë.

2.7 Mostra

Në pjesën empirike pasqyrohen krijimet e disa nxënësve të klasave të nënta IX/1, IX/2, IX/3, IX/4, IX/5, me të cilët kam punuar prej vitit shkollor 2022/2023/2024/2025 të Sh.F.K. "Ismail Qemali" Gostivar, Republika e Maqedonisë së Veriut. Në këtë hulumtim u respektua Kodi Etik i të Drejtës së Autorit duke u marrë pëlqimi i nxënësve për t'i publikuar punimet e tyre, të cilët reagojnë me kënaqësi të madhe. Në Tabelën 1. pasqyrohen emrat e 20 nxënësve që kanë krijuar poezi, ndërsa në Tabelën 2. pasqyrohen emrat e 14 nxënësve, autorë të esejeve të pasqyruara.

Tabela 2: Pasqyrimi i mostrës së këtij hulumtimi për poezitë

Emri mbiemri	Poezi	Klasa	Viti shkollor	Institucioni arsimor-shkolla
1. Redon Banjica	Poezi	VII/1	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
2. Blenda Mustafa	Poezi	VII/1	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
3. Rita Selimi	Poezi	VII/1	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
4. Edian Abdulli	Poezi	VII/3	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
5. Erina Sulejmani	Poezi	VII/3	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
6. Blenda Abdullai	Poezi	VII/3	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
7. Besim Jashari	Poezi	VII/3	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
8. Kushtrim Haliti	Poezi	VII/3	2022-2023	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
9. Dorart Isaku	Poezi	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
10. Lina Xhelili	Poezi	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
11. Erina Beshiri	Poezi	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
12. Drilon Jusufi	Poezi	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
13. Esra Mustafi	Poezi	IX/2	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
14. Zejnep Sejдини	Poezi	IX/2	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
15. Genc Amzi	Poezi	IX/2	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
16. Anik Xhaferi	Poezi	IX/4	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
17. Kaltrina Zulbehari	Poezi	IX/4	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
18. Haula Aliu	Poezi	IX/4	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
19. Amra Fazlija	Poezi	IX/4	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
20. Hana Imeri	Poezi	IX/4	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV

Tabela 3: Pasqyrimi i mostrës së këtij hulumtimi për 14 esejet e krijuara nga nxënësit

Emri mbiemri	Krijimi	Klasa	Viti shkollor	Institucioni arsimor-shkolla
1. Edian Abdulli	Esej	VIII/3	2023-2024	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
2. Deona Abazi	Esej	VIII/5	2023-2024	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
3. Esra Mustafi	Esej	VIII/2	2023-2024	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
4. Erina Beshiri	Esej	IX/1	2023-2024	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
5. Redon Banjica	Esej	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
6. Melisa Rustemi	Esej	IX/2	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
7. Lina Xhelili	Esej	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
8. Erina Beshiri	Esej	IX /1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
9. Lanika Osmani	Esej	IX /1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV

10. Vesa Stafai	Esej	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
11. Sokol Fejzullau	Esej	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
12. Lanika Osmani	Esej	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
13. Amra Fazlija	Esej	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV
14. Ermal Imeri	Esej	IX/1	2024-2025	Sh.F.K. "Ismail Qemali Gostivar", RMV

3. Pjesa Empirike Aplikative Aksionale

3.1 Strategjia konstruktiviste e mësimdhënies në orët e gjuhës shqipe të krijimtarisë

Ky kapitull pasqyron krijimtarinë e nxënësve të klasave të VII, VIII, IX të viteve shkollore 2023-2024-2025. Pasqyrohen eseja^{xiv} përshkruese të krijuara nga disa nxënës të shkollës sonë, që i kanë krijuar për tema të ndryshme duke i shprehur qëndrimet e tyre individuale për çështje të ndryshme, që i vërejnë dhe i përjetojnë në përditshmëri.

Në fillim pasqyohen eseja të përgatitura qëllimisht për pjesëmarrje në konkursin e "31 Tetor-Ditës Botërore të Kursimit" të organizuar nga Banka Botërore dhe Minsitria e Financave, Shkup. Në vitin 2023 një eseje u klasifikua në vendin e parë në nivel qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa në vitin 2024 nuk u zgjodh asnjë nga shkolla jonë, edhe pse kishte tri konkures. Esejat ishin të shkruara me ecuri kronologjike, por kriteri i konkursit kërkonte eseja të kishte 1500 fjalë, prandaj esejat për kurasimin janë më të gjata me disa paragrafë.

Ky ishte edhe shkaku përse vendosa t'i publikoj esajat e tyre, që t'i motivojë nxënësit të shkruajnë, por edhe ju t'i lexoni për ta vlerësuar punën e tyre. Mosha e nxënësve ka ndryshuar, por aftësitë dhe shkathhtësitë e të shkruarit individual të tyre janë zhvilluar gradualisht duke i shfrytëzuar njohuritë e mëparshme, përvojën krijuese dhe vullnetin për të krijuar diçka të re.

Nxënësit e klasës së IX kanë krijuar eseja të ndryshme për raste të ndryshme:

- Vlerën e kursimit për të marrë pjesë në konkursin e organizuar nga Banka Botërore dhe Ministria e Financave –Shkup për rastin e "31 Tetor-Ditës Botërore të Kursimit".
- Portretizmin e personave të ndryshëm, përshkrimi i jashtëm (fizik) dhe përshkrimi i jashtëm (psikik dhe emocional).
- Vlerën e krijimit të kulturës Ekologjike me respektimin e Eko-Standardeve.
- Pasqyrohet edhe një eseje për vlerën e arsimimit, punës dhe vullnetit.

Nxënësit për të shkruarit e esejavë ishin të orientuar për ta sqaruar konceptin e kursimit me organizues grafik "Hartë konceptesh" për të shprehur "stuhi idesh", ishin të orientuar me disa pyetje divergjente për formulimin e kornizës tematike për ta rrëfyer procesin e kursimit dhe për ta rrëfyer qëllimin e kursimit se përse u nevojitet të krijojnë një buxhet individual.

^{xiv} Sqarim: Në këtë punim fjala "ese" përdoret në formën "eseje" për shkak se ky krijim letrar-shkencor në çdo gjuhë përdoret eseje, kurse edhe nga vet Gani Luboteni në librin Teoria e letërsisë (1964), që konsiderohet edhe si libri orientues i fushës "Teoria e letërsisë".

Në këto eseja përshkruhet procesi i kursimit me synime të ndryshme të individ të ndryshëm, që jetojnë në familje të ndryshme me kushte të ndryshme sipas statusit social familjar të ndryshëm.

Gjithashtu pasqyrohen edhe disa eseja për portretizimin e personave të preferuar si të arsimtares, babait, gjyshes etj., por edhe disa eseja për Eko-Standardet. Portretizimi i personazheve mbështetet në njësitë mësimore të zhvilluar dy orë më parë, ku bëhet portretizimi i personazheve:

- Në tekstin “Konica dhe qëllimi i jetës së tij” (2020:84) nga Fan Stelian Nolit
- Në tekstin “Të falem o mësues!” (2020:89) nga reportazhi autobiografik i Ramiz Kelmendit kushtuar mësuesit të tij Esad Mekulit publikuar në gazetën “Jeta e re”.
- Pasqyrohen edhe disa eseja për Eko-Standardet.

Gjatë orëve të krijimtarisë, për krijimin e këtyre esejave nuk ka munguar vullneti im për t’i orientuar nxënësit me strategji konstruktiviste për fillimin dhe zhvillimin e procesit së të shkruarit deri në arritjen e një krijimi pragmatik efektiv dhe prezantimin e tij para auditorit ose deri te lexuesi. Çdo orë krijimtarie për të arritur reflektimin e krijimeve të mira kërkon edhe zhvillim të mësimdhënies konstruktiviste.

Krijimtaria çdo herë duhet të zhvillohet orën e tretë të javës ose të katërt të javës, pasi të zhvillohet ndonjë njësi mësimore me temë e ngjajshme. Nxënësi informatat e krijuara dy orë më parë i lidh me informatën e re të parashtruar për të krijuar një krijim të ri. Ai i rikujton njohuritë e mëparshme nga përjetimet e veta dhe përvojat e individuale të zhvilluara në bashkëveprim reciprok me të tjerët i bashkërendit në krijim të ri duke i rrëfyer si ngjarje reale të përditshmërisë.

3.2 Strategji e mësimdhënies konstruktiviste

Lënda : Gjuhë shqipe

Tema: Të shprehurit dhe krijimtaria

Njësia mësimore: Ushtrim me shkrim- Të shkruarit e një eseje përshkruese-Titulli i temës
Metodat e punës: Bashkëbiseduese për sqarimin e koncepteve me organizues grafik”stuhi idesh”, parashtrimi i pyetjeve divergjente, të shkruarit e krijimit, prezantimi, diskutimi.

Mësimi i integruar: Njohuri nga fusha të ndryshme, perceptime, përjetime nga përditshmëria dhe përvoja të shkruarit për të gjeneruar krijim të ri.

Format e punës: Frontale, individuale, në dyshe, në grup .

Hapi i parë: Bashkëbisedimi për sqarimin e fjalëve kyçe me shprehjen e ideve, që shënohen në një organizues grafik në dërrasë të zezë ose nëse ka mjete teknologjike i shënohen në kompjuter. Paraqesim organizues grafik “Hartë konceptesh” si shembuj për sqarimin e koncepteve kyçe për dy temat e esejave të pasqyruara. Përceptimi vizual është instrumenti më i mirë për klasifikim të njohurive të mëparshme. Idetë e nxënësve shënohen me një organizues grafik në dërrasë të zezë ose nëse ka mjete teknologjike shënohen në kompjuter. Nxënësit për çdo ide të shprehur motivohen me ndonjë fjalë lëvdëruese. Njohuritë e mëparshme të nxënësve janë krijuar nga mësimet e mëparshme, nga përvojat e të shkruarit të mëparshëm dhe nga përjetimet individuale.




Figura 2: Organizues grafikë "Harta e konceptit"

Hapi i dytë: Nxënësit orientohen edhe në të shkruarit e përmbajtjes së krijimit me parashtrimin e disa pyetjeve divergjente për zhvillimin e ecurisë kronologjike të krijimit.

Tabela 4: Pyetjet divergjente të përdorura gjatë orëve mësimore për të shkruarit e krijimeve

Pyetjet për kursimin	Pyetjet për personin e preferuar
Çfarë është kursimi?	Përse ky person është personi më i preferuar i juaji?
Përse duhet të kursesh?	Si duket ai person?
Si vendose të fillosh të kursesh?	Si vepron ai person me ju?
Si vazhdove me procesin e kursimit?	Si vepron me të tjerët?
Përse mendon të kursesh edhe më ?	Përse dëshiron të jesh në afërsinë e tij/le saj?
Çfarë do të bësh me të hollat e kursyera?	Çfarë dëshirove ke për të ardhmen tuaj?

Hapi i tretë: Sqarohen kriteret e strukturës së esejes:

- Eseja të formulohet me paragrafë nga 5-6 rreshta,
- Në mes rreshtave të paragrafëve të ketë nga dy zbrastira
- Eseja të shkruhet në mes të faqes, kurse anash të ketë largërsi dy gishta nga fundi i fletës.
- Eseja të shkruhet në gjuhën letrare.
- Të respektohen rregullat drejtshkrimore për të shkruarit e fjalëve
- Përdorim të drejtë të shenjave të pikësimit.

Hapi i katërt: Angazhimi në të shkruarit e esejes, kontrollimit, korrigjimit, rishkruarit, leximit.

Hapi i pestë: Prezantimi i krijimit para shokëve/shoqeve të klasës.

Hapi i gjashtë: Diskutimi për vlerësimin e temës më të mirë.

Në vijim i pasqyrojmë esejat e nxënësve të klasës së VIII dhe IX, për të reflektuar arritjet e mësimdhënies konstruktiviste.

4. Eseja të krijuara nga nxënësit e klasës së VIII për kursimin 2023-2024

4.1 Kursej me mençuri- jetoj më mire: investoj në të ardhmen time

Në jetën time, kam mësuar shumë për rëndësinë e kursimit të parave dhe marrjen e vendimeve të mençura për to. Kjo esej eksploron çfarë është kursimi, si e vendosa të kursej dhe se si familja ime ka ndikuar në këtë rrugëtim. Në vijim për të sqaruar

shprehinë e kursimit kam ndjekur disa pyetje strategjike, të cilave jam munduar t'iu jap përgjigje.

Pra çfarë është kursimi në përgjithësi? Kursimi është një ide e thjeshtë - është një shprehje e zakonshme e njeriut, kur një pjesë të parave tuaja i mbani anësh për kohën e ardhshme. Kursimi është një zakon financiar që ju ndihmon të jeni gati për gjëra të papritura dhe të bëni të jetuarit në kushte të mira më të qëndrueshme. Kjo për mua do të thotë të siguroj atë që do të më nevojitet në të ardhmen për t'i ndjekur ëndrrat e mia.

Si fillova të kursej? Shprehja e ishte zgjedhja ime e pëlqyer, por edhe familja ime pati ndikim të madh në këtë. Prindërit e mi më treguan pse është e rëndësishme të kursejsh. Ata kursyen paratë dhe më inkurajuan të bëja të njëjtën gjë. Mësova edhe se si të jem i mençur me paratë. Gjyshërit e mi më ndihmuan gjithashtu duke më treguar se si të bëja buxhet dhe të shpenzoja me mençuri.

Paratë i ndaja në dy pjesë: disa për të kursyer dhe disa për të shpenzuar.

Kursimi është një sfidë me momente të vështira dhe fitore personale. Në fillim, ishte e vështirë të ndaja para për kursim, sidomos kur dëshiroja t'i shpenzoja për gjëra argëtuese. Por mësova të vendos synime dhe të kurseja pak nga pak çdo muaj. Një sfidë tjetër ishte ta ndjekja planin tim. Ndonjëherë doja vërtet të shpenzoja më shumë, por mbeta i disiplinuar dhe vazhdova të kursej. Mënyra sesi do të përballja shpenzimet e papritura, si rastet urgjente, ishte çështje komplekse. Mësova se kursimi është proces i vazhdueshëm, që ka nevojë për disiplinë dhe planifikim.

A kam kursyer sa duhet? Kursimi kërkon kohë për t'u arritur, prandaj unë vendosa të kursej, vazhdova të kursej një pjesë të konsiderueshme të parave të mia, por ndonjëherë ka pasur periudhë, kur nuk kam mundur të kurseja sa doja. Për mua, çështja e kursimit është të vazhdosh të kursejsh gjatë kohë se paratë kanë një rëndësi të madhe për të ardhmen time. Ata më ndihmojnë të ndjek ëndrrat e mia, të jem i qëndrueshëm financiarisht dhe të bëj gjëra të mira në botë. Më japin mundësinë të investoj në arsimimin tim dhe në karrierën time të ardhshme.

Sigurisht që keni dëgjuar shprehjen "Arsimi është fuqi." Paratë më ndihmojnë të fitoj këtë fuqi. Investimi në arsim është një nga gjërat më të mira që mund të bëj. Për mua, paratë janë një mjet që do të më ndihmojë të fitoj njohuri dhe aftësi të reja për punën time të ardhshme. Përveç arsimimit, paratë më japin mundësinë të udhëtoj dhe të eksploroj botën, që është një mënyrë fantastike për të mësuar gjëra të reja, si kulturat dhe traditat. Udhëtimi më ndihmon të kuptoj më mirë veten, të shoh panoramën e madhe të jetës, të fitoj kujtime dhe zgjeroj kulturën personale.

Paratë janë një faktor i rëndësishëm në jetën time, që ndikojnë në mënyrën se si unë jetoj dhe si e planifikoj të ardhmen time. Ata më ndihmojnë të ndjek ëndrrat e mia, më japin stabilitet financiar dhe përmirësojnë jetën time. Investimi në kursim është pjesë e planit tim financiar, që bëhet një burim i çmuar për të investuar në vende të ndryshme.

Investimi në kursim është si të mbjellësh një pemë parash, që rritet me kalimin e kohës. Kjo pemë mund të më ndihmojë të jetoj një jetë komode, të blej një shtëpi të re dhe të siguroj një pension të rehatshëm kur të plakem. Paratë gjithashtu më japin lirinë për të bërë atë që dua, të merrem me hobitë e mia, të shijoj gjithçka në jetë, të eksploroj vende të reja, të njoh kultura dhe njerëz nëpër botë dhe të mësoj gjuhë të reja.

Paratë ofrojnë mundësi për të qenë human për t'i ndihmuar të tjerët, që kanë nevojë për ndihmë. Paratë më japin mundësinë për ta bërë këtëgjë humane. Paratë e kursyera thjeshtë nuk janë shuma e arritur, por si do t'i përdor ato për të bërë jetën më të mirë. Mua parat e kursyera më ndihmojnë të arrij synimet, të jem i qëndrueshëm dhe të bëj ndikim pozitiv tek të tjerët. Kjo më nxit të fokusohem në menaxhimin e parave me mençuri dhe përgjegjshmëri.

Ruajtja e parave është shprehje shumë e rëndësishme, sidomos kur të jetuarit bëhet e vështirë, njeriu përballlet me shumë sfida, atëherë kursimi bëhet mjet sigurie për t'i përballuar vështirësitë. Një rast të tillë përjetuam gjatë "Pandemisë COVID-19", kur e pamë sa e nevojshme ishte paraja. Shumë njerëz u larguan nga puna, disa morën më pak të ardhura, ndërsa ata që kishin kursyer ishin në një pozitë më të mirë për ta përballuar këtë sfidë.

Kursimi i parave ofron siguri financiare për gjindshmëri në situata jetësore të vështira, që të nxit me mençuri të gjesh mënyrën e shpenzimit të më pak të hollave për të kursyer më shumë. Ne duhet t'i planifikojmë shpenzimet dhe të kërkojmë këshilla se si t'i menaxhojmë paratë, të mendojmë për mënyra të reja si të fitojmë më shumë para, si puna online.

Gjëja tjetër e rëndësishme është të ndihmojmë të tjerët në situata të vështira. Ne mund ta ndihmojmë familjen, miqtë dhe shokët. Ne duke ndarë pak para nga tona, mund të bëjmë një ndryshim të madh edhe në jetën e njerëzve me nevojë, ta ndryshojmë jetën e tyre. Kjo tregon se ne kujdesemi për të tjerët dhe dëshironi t'i ndihmojmë të tjerët.

Kursimi i parave gjatë kohëve të vështira është një shprehje e mençur, që duhet të bërë nga gjithë. Kursimi është realizimi i planit të shpenzimit të parave për t'u ndjerë i sigurtë, mundësi për t'i ndihmuar të tjerët dhe për të bërë botën një vend më të mirë. Këto janë mësimet e rëndësishme që unë do t'i ndjek në të ardhmen dhe do t'i inkurajojë edhe të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë.

25.10 2023, Gostivar

Edian Abdul, Klasa VIII/1 (vendi i parë)

4.2 Kursej me mençuri-jetoi më mirë: investoj në të ardhmen time

Unë, Deona, jetoi në një qytet të vogël, ku jeta ndryshon vazhdimisht. Mua më bënë të dallueshme nga anëtarët e familjes dhe miqtë e mi tipari i veçantë, që tani më kaloi edhe në shprehje jetësore, tipari i kursimit të parave. Unë vendosa t'i ruaja një pjesë të parave, ndërsa të tjerët i shpenzonin paratë për t'u kënaqur, për të blerë ushqim, tesha, mbathje dhe për argëtime të ndryshme.

Unë u bëra njeri i çuditshëm, çdo para që kalonte në duart e mia e shihja me kujdes, i llogarisja dhe i shpenzoja një pjesë, kurse një pjesën tjetër e kurseja. Prindërve çdo ditë u kërkoja para për ndonjë shkak si për ekskursion, për të dalë me shoqërinë, për të blerë diçka, por asnjëherë nuk i shpenzoja të gjithë paratë, por çdoherë kurseja.

Një ditë, nëna ime e vërejti se unë nuk i shpenzoja paratë qëllimisht se dëshiroja t'i kursejë ato. Ajo më qortoi, më tha se me paratë e kursyera të blejë diçka se ajo atë ditë nuk kishte para të mjaftueshme të më jepte, se asaj i isha dukur si e pa veshur mirë. Unë

atëherë u ndjeva e ofenduar dhe vendosa t'i shpenzojë paratë për të blerë tesha, që t'i dukem nënës e veshur.

Një ditë bleva tesha dhe bleva një kukull për t'i treguar nënës se i shpenzojë paratë, për të cilën gjë nëna më lëvdroi shumë. Kukullën e vendosa në dhomën time, të cilën kur e shoh e kujtoj shkakun e blerjes së saj. Unë u pendova se i shpenzoja të gjithë paratë e kursyera, që nëna ime të më përceptonte si një person të mirë. Kënaqësia e saj ishte që unë të jem e veshur me rroba të reja, por kënaqësia ime ishte të kursej, prandaj vendosa përsëri të kursej pa i treguar nënës sime.

Unë vendosa të kurseja para përsëri, ashtu që një ditë kur shkova në shitore me shoqet e mia unë nuk bleva asgjë për të ngrënë, ndërsa të tjerët blenë. Ata më pyetën pse nuk bleva asgjë, por unë kurrë nuk u tregova se po kurseja. Të gjithë flisnin me njëri-tjetrin, por unë i mendoja fjalët e nënës sime, se paratë duhet të përdoren për t'a ruajtur shoqërinë për të përjetuar momente të bukura e të paharrueshme, e jo t'i kursejmë ose t'i shpenzojmë për të blerë gjëra të panevojshme.

Përpyekja për të kursyer ndonjëherë të bën të paveshur, siç u bëra edhe unë. Paratë e kursyera nuk i shpenzoja, nuk bleja asgjë, ashtu që fillova të bëhem koprrace, kur dilja me shoqet se lejoja ato të paguanin për mua. Kjo sjellje ime e keqe më nxiti të mendoj se ndonjëherë duhet ta kënaq edhe veten se vitet kalojnë dhe moshja e adoleshencës nuk kthehen më. Unë fillova me mençuri ta planifikojë kohën e shëtitjes me shoqërinë, por edhe paratë t'i shpenzojmë me maturi.

Kursimi është shprehja më e rëndësishme, që ndihmon në sigurimin e të ardhmes financiare, prandaj edhe bëhet shprehja më parimore. Ne si fëmijë nuk punojmë si të rriturit, por nga paratë që na i japin anëtarët e familjes për shpenzime ditore 100 denarë, mund të ndajmë 10 denarë në ditë për t'i kursyer, ashtu që për një vit mund të kursejmë 3650 denarë në vit. Festat na japin mundësi të kursejmë se mysafirët, që vinë në vizitë na japin para. Paratë e kursyera sot në të ardhmen bëhen lehtësues për arsimim, për banim, etj. Kurseni tani për lehtësuar të ardhmen!

25.10 2023, Gostivar
Deona Abazi, Klasa VIII/5

4.2.1 Eseja për portrezimin e një personi të preferuar kl.VIII

4.2.1.1 Personi im më i preferuar

Arsimtarja ime e dashur, të flasësh për arsimtarët është pak vështirë se arsimtarë janë aq me vlerë sa janë bërë të rëndësishëm për nxënësit. Të gjithë arsimtarët për mua janë shumë të mirë dhe shumë të veçantë, por për mua më veçantë është arsimtarja e gjuhës shqipe, e cila më tepër më ka hyrë thellë në zemër nga të gjithë arsimtarët.

Qysh kur kam qenë në klasë të VII ajo për mua ka qenë arsimtarja më preferuar. Ajo është një arsimtare shembullore për rregullshmëri në punë dhe mësimdhënie të kuptueshme, por ndonjëherë edhe pak e rreptë për të mirën tonë. Shembulli i saj është shumë i mirë për rregullshmërinë time në mësim, por edhe për rregullshmërinë e nxënësve të tjerë.

Gjatë orëve mësimore ka raste edhe kur qeshim, por ka raste edhe kur arsimtarja ynë mërzhitet, ku ndonjëri nga nxënësit bëhet i mërzhitshëm, bën zhurmë dhe nuk është i

vëmendshëm në mësim. Ajo na këshillon neve sikur të ishim fëmijët e saj, ashtu që atë mësim ose punë që nuk mund ta bëjmë ajo me këshillën e saj na nxit ta bëjmë me përpjekje dhe vullnet për të arritur sukses.

Arsimtarja ime si në të folur, si në të veshur, si në të vepruarit në mësim dhe në të vepruarit në është shembull për ne. Ka raste kur disa nxënës kanë bërë disa gabime të pafalshme, të cilat arsimtarja nuk mund t'i tolerojë, por ajo me këshilla dhe qortime i orienton ta rregullojnë sjelljen e tyre nga sjellja e pakënaqshme në të sjellje kënaqshme gjatë orës mësimore.

Mërzitja e saj vërehet edhe në sytë e saj, kur se nxënësi fillon ta teprojë me sjellje arrogante ndaj shokëve dhe shoqeve të vet gjatë orës mësimore, por ajo çdoherë e përdor mënyrën e duhur për ta rregulluar sjelljen devijuese të nxënësit arrogant, të paineresuar për mësim, por ndonjëherë edhe agresiv.

Arsimtarja është shumë e sjellshme, e dashur dhe zemërmirë, ashtu që është bërë për ne një arsimtare shembullore, që çdonjëri duhet ta ndjek shembullin e saj. Unë arsimtaren time e dua shumë, por nuk mund t'ia shpreh sepse jam një tip i tillë. E falënderoj shumë dhe me gjithë zemër arsimtaren time për punën dhe kujdesin, që e bën për ne.

17.10.2024, Gostivar
Esra Mustafi Kl.VIII/2

4.3 Eseja të krijuara nga nxënësit e klasës së IX për kursimin 2024-2025

4.3.1 Kursimi-shprehi dhe nevojë e jona- klasat e IX -2024/2025

Ideja për kursim më lindi në tetor të vitit 2023, kur arsimtarja e gjuhës shqipe, na njoftoi se do të mbahej një Konkurs me rastin e Ditës Botërore të Kursimit-31 Tetor i organizuar nga Banka Botërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Atë ditë unë u motivova të kursej të holla për të krijuar një buxhet rezervë edhe pse isha në moshën 13 vjeçare.

Ky njoftim më nxiti të hulumtoj, në internet dhe në fjalor, për ta kuptuar domethënien e konceptit kursim, ku sqarohej si veprim i të mos shpenzuarit të së gjithë të ardhurave mujore, ku një pjesë e të ardhurave ndahej dhe nuk shpenzohej, por kursej për të krijuar një buxhet rezervë si siguri për nevojat e sfidave të ardhmërisë.

Shprehitë e kursimit çdo njeri i krijon me përsëritjen e veprimeve të njëjta disa herë duke mos i shpenzuar të hollat e pashpenzuara. Në shekullin XXI, në botë dhe në vendin tonë, si nevojë për ta siguruar të ardhmen kërkohet nga çdo njeri ta zhvillojë shprehinë e kursimit, për shkak të rritjes së shpejtë të çmimeve të faturave, rritjes të çmimeve të produkteve të ndryshme.

Çdo njeriu i nevojitet zhvillimi i kulturës për kursim, por për atë mund të aftësohet me anë të hulumtimeve në internet dhe njoftimeve në institucione, ku ofrohen sqarime për vetëdijesim e njerëzve se si të veprojnë me të ardhurat, si t'i menaxhojnë më mirë të hollat për të bërë më pak shpenzime dhe si të ndajnë një pjesë nga të hollat për kursim për të krijuar një buxhet rezervë.

Shprehia e kursimi arrihet me të kursyerit në vazhdimësi, me përsëritjen e veprimeve të njëjta çdo ditë, çdo muaj dhe çdo vit. Në çdo familje prindërit duhet t'i njoftojnë fëmijët me sqarime për veprimet, që duhet t'i ndërmarrin të gjithë për arritjen e shprehive të kursimit. Ata duhet të ndjekin disa objektiva, që t'i realizojnë gjatë përditshmërisë për formimin e buxhetit rezervë.

Qëllimi i kursimit dhe përcaktimi i rregullave për arritjen e buxhetit rezervë duhet të përcaktohen nga të gjithë anëtarët e familjes, që secili të përpiqet t'i menaxhojë të hollat për shpenzim dhe të hollat për kursim. Rregullat më të shpeshta të përcaktuara në familje janë:

- të analizohen të ardhurat mujore për shpenzim dhe kursim.
- të krijohet një buxhet rezervë afatshkurtër dymujorë.
- të mos tentojë anjëri nga familjarët të kërkojë t'i shpenzojë të hollat e buxhetit rezervë.
- çdo anëtarë i familjes t'i reduktojë shpenzimet e panevojshme, por të krijojë buxhetin e vet.
- buxheti i kursyer vazhdimisht të kontrollohet.

Në familjen time vitin e kaluar u morr një vendim i tillë për t'i përballuar sfidat jetësore, që na paraqiteshin çdo ditë me rritjen e çmimeve, që filluan të bëhen pengesë për t'i plotësuar nevojat jetësore elementare për të jetuar mirë. Të gjithë filluan t'i përkushtohen objektivave të përcaktuara për uljen e shpenzimeve për të kursyer të holla për buxhetin rezervë.

Nisma ime për të kursyer filloi në muajin tetor të vitit 2023, kur planifikova të ndajë nga 100 denarë nga shpenzimet ditore, që m'i jepnin prindërit e mi, gjyshi dhe gjyshja. Unë vendosa këto të holla të mos i shpenzojë për të blerë veshmbathje dhe as për të blerë diçka tjetër, por i vendosja në buxhetin rezervë individual për proceset jetësore të ardhmërisë sime.

Unë, pasi jam djali më i vogël dhe më tepër kohë kaloj ditën në shtëpi, vendosa të kem kujdes edhe në përdorimin e energjisë elektrike, që babai im t'i paguante faturat e energjisë elektrike me çmim më ulët dhe t'i ngelnin më tepër të holla për të kursyer ose për të na i shtonte të hollat ditore, që na i jepte mua dhe vëllezërve të mi. Njëlloj filluan të vepronin edhe vëllezërit e mi.

Të gjithë në shtëpi filluam të kujdesemi edhe për përdorimin e ujit në masë më të vogël, për t'i ulur çmimet e faturave të ujit. Ne filluam të kujdesemi për mirëmbajtjen e teshave, që të mos i ndotim dhe të mos lajmë shumë shpesh në lavatriçen e teshave, e cila shpenzon edhe energji elektrike dhe ujë, por edhe të përdoret më pak edhe makina tharëse e teshave dhe hekurosja.

Ne u kujdesëm të mos bëjmë edhe shumë enë, që lavatriçja e enëve të lëshohej një herë në ditë.

Gjithashtu filluam të kujdesemi edhe për mirëmbajtjen e pastërtisë në dhomat tona, të pastërtisë së oborrit, ashtu që nuk na nevojitej më ndihmëse në shtëpi, që t'i kryente këto punë dhe u pakësua edhe një shpenzim. Ndihma jonë i uli shpenzimet ditore në familjen time.

Prindërve filluan t'u ngelnin pak më tepër të holla, ashtu që filluan të na e shtonin shumë e të hollave ditore, kurse të hollat tjera filluan t'i kursenin për të na dërguar neve ta vizitojmë ndonjë qytet të bukur ose për të shkuar në det. Prindërve kurrë nuk u interesonte se ku i shpenzonim të hollat, që na i jepnin, ashtu që unë e krijova buxhetin tim për dëshirat e mia.

Unë fillova të blejë më pak tesha duke e ditur se vitin e ardhshëm do të rritem më shumë dhe ato tesha nuk do të më bëjnë më, ashtu që edhe prindërit i shpëtova edhe nga një shpenzim tjetër. Gjithashtu edhe atletet fillova t'i mirëmbajë për të mos bjerë atlete të reja si e bëja më parë se mua më rritej këmba dhe vitin e ardhshëm nuk do të më bënin më.

Unë fillova ta rralloj daljen me shokë e shoqe në lokale, ku shkonim çdo ditë dhe shpenzonim nga 200-300 denarë. Tani ha bukë në shtëpi, kurse më vonë dalë për shëtitje rreth lumit Vardar. Kjo shëtitje më solli përfitime shëndetësore dhe financiare se shëtita në dy parqeve të qytetit rreth lumit Vardar, mora frymë në ajër të pastër dhe më ngelën të holla se bleva lëng në shitore.

Një ditë unë fillova të bisedoj me dy vëllezërit e mi më të mëdhenj për shëtitjet e shumta, që ata i bënin duke shëtitur nëpër ekskursionet e ndryshme me shokë. Kjo bisedë ata i vetëdijësoi, që të mendonin për të kursyer duke i reduktuar numrin e shëtitjeve të tyre, që në fund të muajit të na ngelin të holla për t'i kursyer për ndonjë nevojë të papritur, që mund të na paraqitej afatgjate.

Shprehinë e të shëtimit me shokë e shoqe e kishin edhe nëna, edhe babai, ashtu që të dy bënin shpenzime shtesë, prandaj ne erdhëm në përfundim se nëse shëtitjet ne i bënim bashkë, me siguri do të shpenzonim më pak sesa shpenzimet, që i bënte secili nëse shëtiste vet. Shëtitjet janë shpenzimet dy-tri ditore të paplanifikuara, ku më së tepërmi e shpenzohen të holla.

Agjensionet turistike për t'i vizituar vendet e ndryshme i ofrojnë ofertat e tyre edhe në internet, por nëse ne tentojmë të vizitojmë çdo vend që e shohim, atëherë na nevojiten shumë të holla. Çdo anëtarë i familjes duhet të mendojë sesa herë në vit mund të dalë jashtë, me të ardhurat, që i fitojnë prindërit. Vizitat në vende të ndryshme kërkojnë edhe zhvillimin e kulturës së kursimit.

Zhvillimi i shpejt teknologjik u ofron mundësi njerëzve duke ndenjur në shtëpi t'i shohin dhe t'i blejnë veshmbathjet përmes internetit. Pëlqimi i çdo modeli të ri të teshave ose atleteve blihen edhe nga shtëpia, por nëse ne blejmë çdo gjë, që shohim duhet të kemi shumë të holla ose t'i kufizojmë blerjet e produkteve elementare jetësore, që na e kufizojnë edhe sigurinë e së ardhmes.

Kursimi është veprim i qëllimshëm, që realizohet me uljen e shpenzimeve ditore me anë të shprehive së kursimit për të krijuar buxhet rezervë për të ardhmen. Gjatë të jetuarit mund të na paraqiten edhe ngjarje të papritura si ndonjë sëmundje shëndetësore të ndonjë anëtarë të familjes, dështimi i biznesit të prindërve, largimi nga puna i ndonjërit prind, ndonjë aksident etj.

Planifikimet për ngjarje të papritura na vetëdijësojnë të kursejmë duke krijuar buxhet rezervë. Kursimi është faktor kyç për të jetuarit të një jete më të mirë, më të lumtur dhe më të sigurt në të ardhmen, por të tepruarit me të kursyerit njeriun e bën edhe

koprrac, që është vetia më keqe njerëzore, prandaj të shpenzuarit dhe të kursyerit duhet të jetë i balancuar ose i ekuilibruar. Kurse sot, për ta siguruar ardhmërinë!

16.10.2024, Gostivar
Redon Banjica, KI/IX 1

4.3.2 Kursimi-shprehi dhe nevojë e jona- klasat e IX -2024/2025

Në shtëpinë time një ditë nga nëna ime e dëgjova fjalën “kursej”, e cila fliste me mërzi dhe thoshte: “Erdhi koha më, që kurrë nuk mund të kursej për të shkuar diku”. Kjo fjalë më nxiti të kërkoj në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe ku kjo fjalë sqarohet si një veprim për të mos i shpenzuar të gjithë të hollat.

Fjala “kursim” dikujt mund t’i duket një fjalë pa vlerë, por kjo fjalë e shkurtë dhe pa vlerë është në fakt shumë e rëndësishme në jetën e ditëve të sotme. Kursimi hap dyert e jetës për mundësi të reja dhe realizim të dëshirave që i ke për në të ardhmen. Jeta ka sfida, ka të papritura, ku gjithçka mund të ndryshojë papritmas, andaj kursimin që e bën sot, të nxjerrë në dritë nesër.

Kursimi është një veprim i njeriut për t’i shpenzuar më me kujdes të ardhurat mujore për blerjen e produkteve ushqimore, për blerjen e produkteve higjienike, për blerjen e veshmbathjeve, për përdorimin e rrymës në kohën e tarifës së lirë, për përdorimin e ujit në sasi më të vogël, për t’i pakësuar shëtitjet, që në fund të muajit t’i ngelin të holla për t’i ndarë anësh për nevojë afatgjate.

Shprehia e kursimit i nevojitet njeriut të sotëm, se tani në çdo anë syri i percepton të mirat materiale, që e nxisin t’i blejë, mirëpo nëse menjëherë e blenë çdo artikull të ri, që e sheh në vitrinë, në të ardhmen e kufizon blerjen gjërave elementare jetësore. Kursimi është një shprehi e qëllimshme, që kërkon disiplinë dhe planifikim për t’i mos i shpenzuar të gjithë të hollat.

Gjatë të jetuarit shpesh herë ndodhin edhe ngjarje të papritura ose të paplanifikuara në jetën tonë, siç janë problemet shëndetësore të ndonjë anëtarit të familjes ose largimi nga puna e prindërve, prandaj kursimi në këto raste bëhet siguri financiare. Ne nëse nuk kursejmë mjaftueshëm mund të përballemi me vështirësi serioze dhe me ndjejnë të fortë pasigurie, por kursimi nuk duhet të shndërrohet në një obsesion që na largon nga gëzimet e jetës së përditshme.

Kursimi është një nevojë për çdo individ dhe për çdo familje, që arrihet me reduktimin e blerjeve të artikujve të ndryshëm dhe me zvogëlimin e shëtitjeve të shpeshta. Në çdo vend të botës, por edhe në vendin tonë ndryshimet ekonomike dhe sociale janë shumë të shpeshta, prandaj kursimi ofron një ndjenjë sigurie dhe kontrolli mbi të ardhmen.

Fjala e nënës më shtyri t’i kujtojë të gjithë ato shpenzime, që unë ua kam bërë prindërve të mi duke u kërkuar të holla për të blerë lodra dhe tesha të panevojshme vetëm për t’i plotësuar dëshirat e mia. Rritje ime kërkonte veshmbathje të re, ashtu që duhej t’i hiqja nga dhoma ime të lodrat fëmijërore dhe teshat e zvogëluara se filluan të më pengojnë në dhomë.

Çdo teshë dhe këpucë e blerë vitin e kaluar u bë e tepërt se ngeli pa u veshur dhe pa u mbathur se unë vazhdimisht rritesha dhe çdo gjë më vinte e vogël. Çdo gjë, që më

ishte zvogëluar vendosëm me nënën t'ia japim një vajze të një kushëriri, që ishte më vogël se unë, për shkak se të gjithë teshat ishin të reja dhe të paveshura, kurse këpucët të pambathura.

Ah sikur t'i kisha kursyer prej më parë tani do të kisha mundësi ta ndihmoja ndonjë vajzë të re, që ka ndonjë sëmundje dhe nuk ka mundësi të shërohet. Unë deri tani i shpenzoja të gjithë të hollat për lodra fëmijësh sipas dëshirës time fëmijërore se më mungonte vetëdijësimi për kursim, por tani mendoj ndryshe, më nuk shpenzoj si më parë, por pak të holla i ndajë për në arkën time.

Unë si fëmijë i moshës 14 vjeçare fillova të vetëdijësohem për të kursyer duke krijuar një buxhet timin, që nëse paraqitet nevoja vitin e ardhshëm të jem e gatshme t'i ndihmojë prindërit e mi për t'i përbaluar shpenzimet. Eh sikur të ishte vetëm një vit?! Mësova edhe një shprehje të re, e reduktova blerjen e veshmbathjeve të panevojshme për të krijuar buxhet për ardhmëri.

Brengosja e nënës më shqetësoi shumë, prandaj fillova të kursej nga të hollat, që prindërit e mi m'i jepnin mua çdo ditë për të blerë diçka për të ngrënë në shkollë. Fillova çdo ditë të ndajë nga 100 denarë nga 200 denarë, që ato m'i jepnin mua për ushqim, por ndonjëherë më ngelnin 50 denarë. Në këtë mënyrë unë fillova t'i kursejë të hollat dhe fillova ta krijojë edhe buxhetin tim.

Gjithashtu edhe për festat e Bajramit në qytetin tim, miqtë që vijnë për Bajram neve fëmijëve na japin nga 200 denarë, por ndonjëherë edhe nga 500 denarë, prandaj vendosa edhe ato të mos i shpenzojë, që shuma e buxhetit tim të rritej. Një ditë fillova të vetëdijësohem se të hollat nuk janë vetëm letër, por një siguri për nevojat jetësore të së ardhmes.

Kursimin ndoshta nuk mund ta bëjmë brenda një nate, por mund ta fillojmë me një numër të vogël parash dhe brenda ditëve të rrisim buxhetin tonë duke shtuar çdo ditë nga pak para në të.

Shpenzimi i shumtë për gjëra luksoze të panevojshme ndikon në përpjekjet për të kursyer. Shprehia e kursimit tani është e nevojshme për çdo individ dhe për çdo familje.

Një natë rashë të flejë me këto mendime, mirëpo në ëndërr pashë se isha rritur dhe isha shumë e lumtur se me buxhetin tim i kisha kryer studimet, kisha blerë një shtëpi të bukur dhe jetoja e lumtur me të afërmit e mi. Të nesërmen kur u zgjova e kuptova se vlera e të hollave nuk është kurrëgjë tjetër, por vetëm të menduarit, të planifikuarit për të vepruar me ta për ta ruajtur lumturinë dhe të jetuarit e mirë pa brenga edhe në të ardhmen.

Barazimi i të shpenzuarit për plotësimin e nevojave jetësore dhe kursimit është faktor kyç për të jetuarit të një jete më të mirë, më të lumtur dhe më të sigurtë edhe në të ardhmen. Kurseni me vetëdijësim duke jetuar mirë!

17.10.2024, Gostivar
Melisa Ristemi IX/2

4.3.3 Kursimi-shprehje dhe nevojë e jona- klasat e IX -2024/2025

Kursimi është një proces i ndarjes së të hollave në dy grupe, të holla për shpenzim dhe të holla për kursim. Kursimi është mënyrë efikase dhe shumë e nevojshme për çdo nxënësin

prej nesh. Rritja e pandërprerë e çmimeve të artikujve ushqimorë, të veshmbathjes, të faturës së energjisë elektrike etj. në vendin tonë na nxit të kursejmë, edhe pse është bërë vështirë për të kursyer.

Në ditët e sotme çmimet rriten çdo ditë, prandaj edhe në çdo shtëpi dëgjojmë kërkesat e prindërve shtohen duke u thënë fëmijëve: “ Hani ushqimet, që të mos i hidhni se çdo gjë është shtrenjtuar, asnjë denarë nuk ngelë për kursim”. Çdo njëri prej nesh sot fillon më pak të shpenzojë në blerjen e gjërave të vlefshme, por orientohet në blerjen e gjërave më të lira.

Zhvillimi i shërbimeve përmes teknologjisë digjitale u mundëson të gjithëve e ta bëjnë transferimin e të hollave prej në shtëpi, të bëjnë pagesën e ujit, të rrymës, të mediave, të blerjes së artikujve veshmbathës etj. Panelët solarë të vendosura mbi shtëpi për prodhimin e energjisë elektrike nga rrezet e diellit disa qytetarëve u ndihmuan ta ulin tarifën e faturës së rrymës.

Sjellja jonë ndryshon me shpenzimin e të hollave, ndikon edhe në lumturinë tonë, kur kemi pak mjete të holla na shtohen shqetësimet, kurse kursimi është buxhet rezervë për t'i larguar shqetësimet tona. Shprehia e kursimi është më mirë të fillohet nga fëmijëria si një mik përkrahës drejt lumturisë dhe rehatisë shpirtërore.

Vendimi për të kursyer ndodhi atë ditë kur i pashë çmimet e rritura, ashtu që fillova të blej më pak artikuj ushqimor dhe veshmbathës. Kursimi i parë ishte pak i vështirë se disa artikuj ushqimor, që i merrja çdo ditë fillova të mos i blejë më. Kështu veprua disa ditë, disa muaj duke krijuar edhe shprehin e kursimit, por edhe buxhetin individual dhe tani ndjehem e lumtur.

Unë si çdo fëmijë tjetër i kam ëndrrat e mia, me të cilat zgjohem në mëngjes, kurse në mbrëmje bie të flejë. Ëndrrat e mia për t'u bërë realitet unë duhet të filloj të kursej për t'i lehtësuar shpenzimet e prindërve të mi. Shprehia e kursimit ndodh nëse veprimi i mos shpenzimit të gjithë të hollave përsëritet disa ditë, muaj dhe vite me radhë.

Kursimi tregon shkathhtësinë e individit për të menaxhuar me të ardhurat e tij duke i planifikuar mënyrën e shpenzimit të tyre duke i ndarë një pjesë së të hollave për kursim. Kursimi është mirë që të fillohet nga fëmijëria të jetë si një mik përkrahës ndaj qëllimeve tona, si ai çelës i hapjes së derës së shkëlqimit të syve tanë nga lumturia.

Me kursimet e mia unë mund të realizojë studimet në të ardhmen ose ato mundem t'i përdori për diçka tjetër si t'i dhuroj të holla njerëzve, që kanë nevojë dhe janë të varfër e jo t'i shpenzojë të hollat vetëm për ta kënaqur egon personale. Të gjithë njerëzve ua rekomandoj kursimin, se është efikas dhe i mirë në këto kohë krize. Kurse sot, që në të ardhmen të jesh falënderues!

17.10.2024, Gostivar
Erina Beshiri, Kl/IX 1

4.4. Personi më i preferuar –te klasat e IX -2024/2025

4.4.1 Personi më i preferuar

Çdo nxënës ka një person të preferuar, dikë jo vetëm që e mëson, por edhe e frymëzon. Personi më i preferuar i im është arsimtarja e gjuhës shqipe, e cila nuk është vetëm arsimtare, që na mëson, por është arsimtare, që na frymëzon për reflektim të kulturës

qytetare. Ajo është parimore në kryerjen e obligimit të mësimdhënies me rregullshmërinë e saj, është e virtytshme, reflekton shkathtësi profesionale-digjitale të mësimdhënies dhe vlerësuese objektive.

Ajo është në moshë gjashtëdhjetëvjeçare, me trup mesatar dhe me flokë të zeza, por gjithmonë është e kujdesshme me veshjen e saj. Veshja e saj e preferuar është kostumi elegant, i thjeshtë, por i zgjedhur me kujdes, i dizajnuar mirë me ngjyrë të zezë, të bardhë ose ngjyrë hiri, me aksesore të thjeshtë e të paktë dhe lëvizje të matur dhe e të qetë nëpër klasë, që e pasqyrojnë kulturën e saj për respektimin e kodit e etik të veshjes në profesionin e mësimdhënies.

Sjellja etike e saj në punë e bën atë të jetë e respektuar nga të gjithë se është gjithmonë e sjellshme dhe e dashur me ne dhe të tjerët, na flet me zë të butë dhe të qetë. Ajo ndaj nesh është empatike, nëse ne mësimin nuk e kemi kuptuar ajo e shpjegon përsëri, nëse bëjmë gabime nuk na kritikon, por na ndihmon të përgjigjemi në mënyrën e duhur. Sqarimet e saja me organizues grafikë na e lehtësojnë të kuptuarit e mësimin duke i kuptuar konceptet kyçe, klasifikimet e llojeve dhe kategorive gramatikore ose letrare. Të folurit e saj në gjuhën letrare, saktë, qartë me intonacion të zërit na e lehtëson të kuptuarit e mësimin. Vlerësimi i hartimeve dhe i testeve kurrë nuk vonohet, por notat merren të nesërmen.

Ajo gjatë orës mësimore na nxit në diskutim me pyetje për çështje nga përditshmëria. Falë angazhimit të saj në mësimdhënie, lënda që na e mëson nuk na duket e vështirë, por bëhet më lehtë dhe interesante për t'u kuptuar. Ajo nuk është vetëm një arsimtare, por edhe nënë e dytë për ne. Nëse dikush nga ne ka ndonjë problem ajo mundohet ta ndihmojë, ta këshillojë, por ndonjëherë dhe ta mbajë sekret problemin e tij, por edhe na qorton nëse nuk përmirësohemi.

Arsimtarja jonë është një grua humane, që kontribuon nga buxheti personal për të blerë pajisje të ndryshme në klasë për t'u ofruar nxënësve kushte më të mira. Ajo na i solli roletat e dritareve, na solli një shkaf për celularët, një varëse për palltot dhe një shkaf për mbajtjen e mjeteve mësimore dhe mjeteve higjienike, që çdo javë na i sillte nga buxheti i saj dhe një shportë mbeturinash. Në klasë të nëntë bleu edhe katër tabela të vogla muri, ku filluam t'i ngjitim i punimet tona.

Ajo nuk na mëson vetëm mësimin, por na mëson si të kujdesemi edhe për mirëmbajtjen e pastërtisë së klasës, ku kalojmë shtatë orë në ditë. Asaj aspak nuk i pengojnë kostumet elegante për t'i i pastruar bankat në klasë, që të na sigurojë një mjedis të pastër për punë dhe na nxit edhe neve ta mirëmbajmë pastërtinë e mjedisit, ku punojmë. Arsimitarja ime është një nga njerëzit më të veçantë që kam njohur, prandaj jam me fat që kam një arsimtare të dashur si Merita Banjica.

17.03.2025, Gostivar
Lina Xhelili Kl.IX/1

4.4.2 Personi më i preferuar –te klasat e IX -2024/2025

Arsimtarja ime është një person i preferuar për mua. Ajo ka një sjellje shumë të mirë ndaj nesh dhe mundohet shumë për ne na këshillon e të na mëson, por ndonjëherë edhe na

qorton për të mirën tonë që të jemi më te mirët e shkollës e më te parët nga të gjithë, si një klasë shembullore.

Ajo është e bukur, mban rroba me ngjyra neutrale, me të cilat duket një zonjë e vërtetë, por është edhe e pastër dhe shumë e kujdesshme në pamjen e saj të jashtme. Ajo reflekton një qëndrim fisnik dhe plot vetëbesim, gjithashtu ngjall edhe respektin ndaj saj. Zëri i saj kumbon me qetësi dhe siguri, një tingull që e mbush klasën me motivim.

Arsimtarja ime është e përkushtuar ndaj mësimdhënies dhe zhvillimit intelektual tonë si nxënës të saj, që mundohet të na përcjellë njohuritë me durim dhe përkujdesje të veçantë. Ajo nuk është vetëm një arsimtare për ne, por edhe një udhërrëfyese, një motivuese dhe një mbështetje shumë e madhe për ne. Jam shumë me fat që kam një arsimtare të mrekullueshme sikur që jeni Ju! Ju faleminderit për çdo gjë që e keni bërë për mua!

29.03.2025, Gostivar
Erina Beshiri Kl. X/1

4.4.3 Personi im më i preferuar–te klasat e IX -2024/2025

Personi më i preferuar për mua është gjyshja ime, që është edhe personi më i rëndësishëm në jetën time. Ajo gjithmonë qëndron në afërsinë time, më përkrah kur dua të blejë ndonjë gjë ose më ndihmon kur më nevojitet ndihmë për kryerjen ndonjë pune. Atë e bëjnë të tillë bujaria dhe humaniteti ndaj të tjerëve dhe puna e pandërprerë për t'i kryer obligimet familjare.

Gjyshja ime është me trup mesatar, me flokë të zeza dhe kaçurrela, por të zbardhura nga mosha e pleqërisë. Kjo pamje e bën atë shumë tërheqëse, prandaj e duam të gjithë anëtarët e familjes. Ajo është një grua e pastër, e shkathtë për çdo punë dhe zemërmirë, që vazhdimisht solidarizohet me ata, që u nevojitet ndihmë, për t'u ndihmuar në çdo punë ose për t'i zgjidhur problemet.

Ajo ndonjëherë mërzitet si çdo njeri tjetër, por edhe di të bëhet nervoze, kur i bëhet ndonjë padrejtësi nga dikush. Ajo nëse e vëren se dikush tjetër mërzitet për mosdisponimin e saj, atëherë menjëherë ndryshon me sjelljen e saj, fillon të qesh për t'i bërë të lumtur të tjerët. Gjithashtu menjëherë edhe angazhohet në punë për t'i kryer obligimet shtëpiake të saj.

Gjyshja ime ka shumë vlerë për mua dhe e dua shumë, edhe pse ndonjëherë e kam mërzitur me sjelljen time të lazdruar. Ajo për mua gjithmonë do të jetë personi më i preferuar dhe më dëshiruar, që gjithmonë dua ta kem pranë edhe kur jam e lumtur, por edhe kur jam e mërzitur.

29.03.2025, Gostivar
Lanika Osmani Kl. X/1

4.4.4 Personi im më i preferuar–te klasat e IX -2024/2025

Personi im më i preferuar është babai im. Ai është një burrë që mban mbi supë vitet dhe vështirësitë e luftës. Flokët e tij ngjyrë hiri janë si kujtimet e një kohe të largët, fytyrë e heshtur, e ftohtë në dukje, por që fsheh thellësi të butësisë dhe urtësisë.

Veshjet e tij janë të thjeshta një bluzë, një palë farmerka, por mbi to rri veshur dinjiteti i një njeriu që ka përjetuar shumë ngjarje të hidhura. Trupi i tij muskolor flet për përballje, për mundime, për qëndresë, por shpirti i tij është i ndritshëm, i pastër si burimi i malit. Babai im është një njeri që nuk flet shumë, por thotë gjithçka me praninë e tij.

Në sytë e të huajve duket i rreptë, i mbyllur, por në zemrën e tij banon dashuria, morali dhe familja. Fjalët e tij janë të pakta, por me peshë, mendimet gjithmonë të thella, të kujdesshme. Ai rrallë zemërohet, sepse e di që forca qëndron në qetësi. Ndihej sa here që mundet, pa u bërë i zhurmshëm, beson në njerëz dhe të dëgjon me zemër të hapur. Ai është tipi i njeriut që mund t'i besosh, të dëgjon për problem pa të gjykuar, për shkak se problemin ta kupton pa i folur shumë.

07.03.2025, Gostivar
Sokol Fejzullahu Kl.IX/1

4.5 Ta kursejmë energjinë elektrike (EKO-STANDARD-2)

Energjia elektrike është energjia më e nevojshme për funksionimin e jetës normale të njerëzve të shekullit XXI. Kjo energji është shumë e rëndësishme për çdo familje dhe për tërë shoqërinë se pa të nuk mund të funksionojë asnjë pajisje teknike-teknologjike, në shtëpi, në institucion dhe në rrugë. Pa energji ne nuk mund t'i kryejmë punët tona, për shkak se ajo na e siguron ndriçimin gjatë natës, përgatitjen e ushqimit, larjen e teshave, larjen e enëve, pastrimin e shtëpisë, funksionimin e frigoriferit, nxehjen e ujit, ngrohjen e dhomës gjatë ditëve të ftohta të dimrit etj.

Pa energji elektrike nuk ka jetë në shekullin XXI se pa të nuk mund të shohim edhe programe televizive dhe nuk mund të përdorim kompjuterin, për ta thyer monotoninë e mbrëmjes. Mirëpo këto vitet e fundit na u shtua edhe një shqetësim i madh, që e ndjeu çdo anëtar i familjes, për shkak se filluan edhe diskutimet për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Rritja e çmimit në faturat e energjisë elektrike, filloi t'u ndryshojë njerëzve disa shprehi.

Në çdo familje përdorimi i energjisë elektrike filloi të përdorej me maturi të madhe, duke filluar nga fikja e dritave për ndriçim dhe nxemjen filluam ta lëshojmë natën. Bojlerin e ujit, filluam ta lëshojmë vetëm sipas nevojës. Lavatriçen e teshave dhe të enëve filluam t'i lëshojmë pas orës 22:00, edhe atë tri-katër herë gjatë javës. Të gjithë filluan të lahem me rrallë gjatë javës, filluam të mësojmë gjatë ditës dhe mësuam t'i largojmë mbushëset e celularëve nga priza.

Kursimi i rrymës për ulje të faturave na detyroi të mendojmë edhe mirëmbajtjen e pastërtisë në mjedisin e shtëpisë, ashtu që filluam edhe më rrallë të fshimë me fshisë elektrike. Shpresojmë se ulja e çmimit të energjisë elektrike do të na e mundësojë, që çdo pajisje të funksionojë në çdo kohë, që ne me kënaqësi të lëvizim nëpër shtëpi. Ulja e çmimit të energjisë do të ndikojë edhe në përmirësimin e kushteve në institucione ku njerëzit të punojnë, që me vullnet t'i qasen punës.

Data: 10.04.2025. Gostivar
Lanika Osmani Kl.IX/1

4.6 Të kujdesemi për mirëmbajtjen e pastërtisë në çdo mjedis jetësor–IX -2024/2025 (EKO-STANDARD-3)

Kujdesi i çdo njeriu për mirëmbajtjen e pastërtisë në çdo mjedis jetësor duhet të reflektohet nga çdonjëri në çdo mjedis, ku jeton dhe vepron. Çdo qenie njerëzore duhet të jetë shumë i kujdesshëm për mirëmbajtjen e pastërtisë së mjedisit, ku jeton dhe vepron, por mjedisi i pastër është shumë i nevojshëm edhe për kultivimin e kafshëve, shpezëve dhe bimëve.

Çdo mbeturinë e hedhur në sipërfaqe të tokës, bëhet hedhurinë, që lëshon helme të ndryshme dhe bëhet shkaktar për paraqitjen e shumë sëmundjeve dhe vdekjen e njerëzve, por edhe të gjallesave të tjera. Shkaktarët kryesorë për ndotjen e mjedisit janë djegia e mbeturinave nga njerëzit, djegia e fosileve (kafshëve të cofura), mbeturinat e fabrikave, mbeturinat nga ndërtimet e objekteve etj.

Papastërtia më e madhe në qytetin tonë, ku jetojmë dhe veprojmë gjatë përditshmërisë vërehet në qendër të qytetit dhe rreth lumit Vardar, ku njerëzit e kalojnë kohën e lirë. Lumi Vardar buron në fshatin Vërtok në rrethinën e Gostivarit, por ka në vlerë të çmueshme natyrore se është lumi më i gjatë (388 km), që kalon nëpër Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse derdhet në detin Egje.

Lumi Vardar duhet vazhdimisht të jetë i pastër si për vendasit, por edhe për turistët se është vendi më atraktiv në qytetin tonë. Fatkeqësisht kultura njerëzve akoma është në nivelin e ulët për Eko-Standardet se në shtratin e këtij lumi vërehen shumë hedhurina të ndryshme si mobilje, qilim, jorgan, ushqim, shishe plastike etj. Kjo pasuri natyrore duhet të mbrohet, e jo të ndotet e të bëhet vend helmues për përhapjen e sëmundjeve, që të mos e vizitojë më asnjë njeri.

Mënyrat parandaluese për ndotjen e mjedisit jetësor janë të shumta, por mënyra më e rëndësishme është ngritja e kulturës vetjake e çdo njeriu për të ndikuar në kulturën kolektive qytetare për Eko Standardet. Edukimi i secilit për kujdesin e mirëmbajtjes së mjedisit jetësor të pastër fillon nga mosha e fëmijërisë në familje, vazhdon në institucione shkollore, vazhdon në moshën e rinisë dhe zgjat deri në moshën e pleqërisë.

Ne për ta mirëmbajtur pastërtinë në çdo mjedis jetësor nuk duhet të hedhim mbeturina në sipërfaqe të tokës, nuk duhet t'i djegim mbeturinat, ndërtuesit e objekteve të kujdesen për mbledhjen e çdo materiali ndërtimor, etj. Ne duhet të kujdesemi t'i ruajmë pasuritë natyrore, prandaj edukimi për Eko-Standardet duhet të jetë primar për të gjithë njerëzit, por edhe zbatimi i tyre të bëhet në çdo hapësirë nga secili. Mos hidhni mbeturina në tokë se bëhen hedhurina!

Data: 10.04.2025. Gostivar
Ermal Imeri Kl.IX/3

4.7 Të kujdesemi për mirëmbajtjen e pastërtisë në çdo mjedis jetësor–IX -2024/2025 (EKO-STANDARD-3)

Pastërtia është një nga shtyllat themelore e një shoqërie të civilizuar, që ofron kushte për të jetuarit e shëndetshëm të njerëzve. Pastërtia nuk ka të bëjë vetëm me higjienën personale të njeriut, por ka të bëjë edhe me higjienën e mjedisit ku vepron si në shkollë,

shtëpi dhe qytet. Çdo njeri don të qëndrojë në hapësirë të pastër, por në të ndotur as një minutë nuk don ta kalojë.

Në çdo vend ku shkojmë hedhim mbeturina, por ne duhet të kontribuojmë me shembullin tonë për të pasur një mjedis të pastër duke i hedhur mbeturinat në shportë. Ky veprim i yni ndikon edhe në ngritjen e vetëdijes së tjetrit, që të mos i hedh mbeturinat në çdo vend të hapësirës, ku ndodhet. Pastërtia bëhet për të mirën e shëndetit të të gjithëve, që veprojnë në atë mjedis.

Në qytetin tonë në Gostivar një nga vendet më të papastërtia është shtrati i lumit Vardar, aty të gjithë njerëzit hedhin mbeturina, nga të cilat shpërndahen edhe aroma të këqija. Gjithashtu shumë i papastër është edhe objekti i “toaletit publik” që ndodhet ndër urën e Vardarit, nga i cili dhjetë vite shpërndahet aroma e keqe, që i shqetëson qytetarët e Gostivarit. Kjo situatë e pazgjidhur prej vitesh kërkon një zgjidhje urgjente nga autoritetet përgjegjëse të qytetit tonë.

Shpresojmë se autoritetet lokale aktuale do ta zgjidhin edhe çështjen e pazgjidhur prej më tepër se disa dekadave të problemit e parkingut përballë “Xhamisë së Sahatit” dhe Postës Qendrore të Gostivarit, ku parkohen shumë vetura, që gjatë lëvizjes bëjnë shumë pluhur. Në atë hapësirë qëndrojnë edhe tri kontinierë që vazhdimisht janë të mbushur, kurse rreth tyre qëndrojnë shumë hedhurina. Edukimi për respektim të Eko-Standarëve është shumë i nevojshëm për të gjithë qytetarët e Gostivarit. Pastërtia është gjysma e shëndetit, por edhe kënaqësia e syrit tonë.

Data: 10.04.2025. Gostivar
Amra Fazlija Kl.IX/4

4.8 Njeriu me arsimim, punë dhe vullnet arrin gjithçka-te klasat e IX -2024/2025

Çdo sukses jetësor arrihet me anë të djersiturit (lodhjes) duke punuar me orët të tërë për atë që duam ta arrijmë. Puna është ajo që na mundëson të shkojmë sa më para, sa më shumë punë aq më shumë sukses, rezultate të shkëlqyeshme. Arsimi është ajo që ne na mundëson të zhvillohemi duke përfutur çdo ditë njohuri të reja, që i lidhim me njohuritë e mëparshme për të krijuar dije.

Çdo gjë është vështirë, por asgjë nuk është e pamundur, nëse kemi ëndërr në të ardhmen të bëhemi dikush si ndonjë fizicent, kimist, matematicent,etj. Çdo gjë mund të arrihet nëse ne nuk largohemi nga puna e përditshme, por me të mësuarit dhe me vullnet mund t'i përballojmë sfidat.

Mua më pëlqejnë lënda e fizikës, e kimisë, e gjeografisë etj, por unë vitin e kaluar isha shumë e dobët në këto lëndë, por gjatë pushimit pranveror i përsërita të gjithë mësimet nga këto lëndë dhe në fund të viti mora pesë të merituar. Tani e kuptove se punë dhe vullnet arrihet çdo gjë.

Njerëzit e suksesshëm janë ato që kanë pasur dështime në jetë, ashtu që dështimi i ka motivuar përsëri të punojnë për të arritur sukses në ndonjë fushë tjetër. Thënia “njeriu mësohet nga gabimet”, është një pohim i vërtetë se edhe unë fillova të mësoj nga gabimi dhe dështimi që e bëra në lëndën e kimisë, por tani arrita ta kuptoj se dështimi më nxiti të punoj, ashtu që tani arrita sukses më të mirë dhe dështimin e konsideroj si

motivim për suksesin tim. Shpresoj se në të ardhmen do të mësojë më shumë në lëndën e kimisë.

07.03.2025, Gostivar
Vesa Stafai Kl.IX/1

5. Përfundim

Kjo pjesë e këtij libri për orientimin e nxënësve në të shkruarit e krijimeve me mësimdhënie konstruktiviste, ka një vlerë lehtësuese për nxënësit, por edhe për mësimdhënësit e gjuhës shqipe se është një mjet ndihmës për ta organizuar punën e tyre, që të nxitet zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues te nxënësi për krijuar krijim pragmatik për të gjithë lexuesit dhe dëgjuesit. Zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues te nxënësit e shkollave fillore gjatë orëve të së gjuhës shqipe në fushën e krijimtarisë nxitet nga disa aspekte arsimore:

- Aspekti pedagogjik arsimimin gjuhësorë e konsideron si mjet për zhvillimin kognitiv, afektiv, psikomotor dhe social të çdo nxënësi, që nxit zhvillimin gradual të njohurive të kësaj lënde me të mësuarit në vazhdimësi koherente dhe kohezive nëntë vite me radhë duke u zhvilluar 4 orë në javë gjatë çdo viti shkollor. Ky qëllim ka objektivat e veta, që nxënësi të zhvillohet duke i zgjeruar njohuritë nga fusha e letërsisë, gjuhës, krijimtarisë dhe medias.
- Aspekti didaktik arsimimin gjuhësorë e konsideron si mjet pune mësimore për t'i zhvilluar shkathtësitë e ndryshme të nxënësve duke u mësuar strategji mësimore të ndryshme për t'u përshtatur në situata të ndryshme, për të zgjidhur problemet sfiduese, për t'i zhvilluar të menduarit kritik dhe krijues të secilit. Qëllimi didaktik është i përcaktuar në dy objektiva:
 - a) nxënësit të mësojnë si të mësojnë vet
 - b) nxënësit të mësojnë si të jetojnë vet duke u përballur me sfida të ndryshme jetësore.
- Aspekti psikologjik arsimimin gjuhësorë si mjet pragmatik për të ndikuar në zhvillimin e sjelljeve individuale dhe shoqërore të njerëzve. Nxënësit krijojnë shkathtësi për t'u shprehur gojari në gjuhën e letrare, por edhe gjatë të shkruarit të krijimeve pragmatike për t'i rrëfyer dhe përshkruar përceptimet, përjetimet dhe përvojat individuale dhe kolektive.
- Aspekti social arsimimin gjuhësorë e konsideron si mjet komunikimi për shoqërizim duke krijuar raporte të mira në mes njerëzve me ndërkëmbime individuale të ndërsjella për bashkëveprime shoqërore. Motivimi i nxënësve për të bashkëvepruar me ndërveprimet e njëri-tjetrit ndodh edhe gjatë orëve të krijimtarisë duke i përdorur edhe idetë e njëri-tjetrit të reflektuara gjatë bashkëbisedimit, por edhe gjatë prezantimit të punimeve në fund të orëve, kur çdo nxënës i zhvillon edhe shkathtësitë e vetëvlerësimit për ta vlerësuar punën e tij duke e krahasuar me punën e të tjerëve.

Të gjithë nxënësit ushtruan të shkruajnë eseja pragmatike me strategji konstruktiviste dhe krijuan përvojë për të shkruarit e esejave, me strukturë, përmbajtje

pragmatike, fjali të qarta të shprehura në gjuhën letrare, mirëpo kur nxënësit nuk orientoheshin nuk mund të bënin krijim të mirë pragmatik.

Kjo më motivoi t'i orientoj nxënësit të përdorin strategji të ndryshme si:

- Të sqarojnë konceptet kyçe të titullit të temës me organizues grafik "stuhi idesh".
- Të parashtrojnë pyetje divergjente për ta rikujtuar procesin e të shkruarit të mëparshëm.
- Ta krijojnë kornizë të ecurisë kronologjike të krijimit me përgjigjet e pyetjeve.
- Ta përdorin gjuhën letrare dhe t'i respektojnë rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.
- Ta përdorin rendin e zakonshëm të gjymtyrëve në fjali.
- Ta lexojnë versionin e parë të shkruar të krijimit.
- Ta korrigjojnë krijimin dy –tri herë për t'i rregulluar fjalitë dhe paragrafët.
- T'i kushtojnë kujdes paragrafëve, që të jenë me numër të njëjtë të rreshtave.
- T'i kushtojnë kujdes hapësirës në mes paragrafëve, që të jetë me dy rreshta të zbrazëta.
- T'i kushtojnë kujdes largësisë nga skaji i faqeve të jetë dy gishta nga të dy anët.
- T'ia japin krijimin dikujt tjetër ta lexojë, kurse vet ta dëgjojnë për t'i përceptuar gabimet.
- Ta prezantojnë krijimin para nxënësve në klasë, pastaj para ndonjë auditori tjetër.
- Ta shkruajnë krijimin në kompjuter dhe të ma dërgojnë përmes e-mailit.

6. Rekomandim

Krijimtaria sipas teorisë kontruktiviste dhe mësimdhënies konstruktiviste për t'u nxitur te nxënësi duhet të kalojë në disa hapa si: parashtrimi i problemit (tema), nxitja e qëndrimit pozitiv te nxënësi për të krijuar krijim të ri me fillimin e bashkëbisedimit për reflektimin e ideve për temën e parashtruar "stuhi idesh", rikujtimi i dijeve të mëparshme nga mësimet e mëparshme dhe përvojat krijuese me parashtrimin e pyetjeve divergjente, krijimi i klimës krijuese të kënaqshme (motivim nga mësimdhënësi), shkruarja e krijimit, kontrollimi i krijimit, leximi me zë i krijimit, leximi i krijimit nga dikush tjetër dhe prezantimi para auditorit.




Figura 3: Organizues grafik për nxitje të krijimtarisë

Shtesë: Në vijim pasqyrohet një instrument vlerësues për vlerësimin e të shkruarit të esejes, me të cilën edhe ju mund t'i vlerësoni të gjithë esejat që i keni në këtë punim

Numri i pikëve	Vlerësim Analitik I Esejes-Organizimi
5 pikë (shkëlqyeshëm)	Eseja ka strukturë me organizim të jashtëzakonshëm, radhitje të mendimeve në paragrafë me 5 rreshta. Në paragrafin e parë janë dhënë sqarime për temën, radhje të ideve kryesore, për të cilat jepen sqarime në paragrafët në vijim. Fjalitë janë të formuluar sipas rendit të zakonshëm: Kryefjalë, përcaktor, kallëzues, kundrinor, rrethanor, kallëzuesor. Largësia prej titullit me paragrafin e parë dhe në mes të paragrafëve të tjerë është nga dy rreshta. Kompozicioni i esejes ka pjesë hyrëse, pjesë kryesore dhe përfundimin. Lidhshmëria e paragrafëve është sipas radhitjes së koncepteve, për të cilat ofrohen sqarime. Eseja është në vijimësi koherente.
4 pikë (shumë mirë)	Eseja ka strukturë të organizuar mirë me radhitje të mendimeve në paragrafë me 5 rreshta. Në paragrafin e parë janë dhënë sqarime për temën dhe radhitjen e ideve ose konceptet kryesore, për të cilat jepen sqarime sipas radhitjes në paragrafët në vijim. Fjalitë janë të formuluar mirë mirë në përshtatje me rendin e zakonshëm. Në mes të titullit dhe paragrafëve ka nga dy hapësira. Kompozicioni i esejes ka pjesë hyrëse, pjesë kryesore dhe përfundimin në paragrafin e fundit. Lidhshmëria e paragrafëve është sipas radhitjes të sqarimit të koncepteve. Eseja është ka vijimësi koherente.
3 pikë (mirë)	Eseja është e organizuar mesatarisht mirë. Struktura e esejes është me tri paragrafë, ku konceptet ose idetë kanë radhitje logjike. Disa fjali janë të formuluar sipas rendit të zakonshëm, por disa deri –diku. Reflektohet edhe lidhshmëri llogjike në mes paragrafëve sipas kompozicionit. Përputhje të kalimeve nga një pjesë në tjetrën.
2 pikë (pranueshëm)	Eseja është dobët e organizuar. Konceptet ose idetë nuk pasojnë njëra pas tjetrës në paragrafin e parë. Lidhshmëria e koncepteve është e dobët. Informata nuk është e qartë dhe e logjike, por bëhet prezantim i vështirë.
1 pikë (fillestar)	Ekzistojnë disa ose nuk ka fare karakteristika organizative. Përmbledhje e rastësishme e ideve të ndërlidhura dobët.
Numri i pikëve	Përmbajtja
5 pikë (shkëlqyeshëm)	Nxënësi shfaq njohuri të thella të ideve relevante dhe të rëndësishme. Eseja ka strukturë të shkëlqyeshme dhe shumë mirë është e organizuar.
4 pikë (shumë mirë)	Nxënësi shfaq njohuri të ideve relevante dhe të rëndësishme. Eseja ka strukturë të mirë dhe mirë është e organizuar
3 pikë (mirë)	Eseja e mesatarisht e organizuar mirë. Shumica e ideve kanë radhitje logjike. Ka Përputhje të kalimeve nga një pjesë në tjetrën.
2 pikë (pranueshëm)	Nxënësi mund të përfshijë ndonjë ide të rëndësishme, pjesë të ndonjë ideje ose disa fakte, por nuk i zhvillon idetë ose nuk përpunon lidhjet ndërmjet tyre.
1 pikë (fillestar)	Nxënësi shfaq kuptim të kufizuar të temës. Eseja nuk ka strukturë, por pasqyrohet vetëm një shkrim i paorganizuar.
Numri i pikëve	Zbatimi I Rregullave
5 pikë (shkëlqyeshëm)	Drejtskrimi dhe gramatika janë vazhdimisht me standard të lartë, kështu të shprehurit e mendimeve është i shumë i qartë dhe i saktë
4 pikë (shumë mirë)	Drejtskrimi dhe gramatika janë përdorur me standard të mirë, kështu që të shprehurit e mendimeve janë të kuptueshme.
3 pikë (mirë)	Hasen disa gabime drejtskrimore dhe gabime gramatikore, por ata nuk ndikojnë në të kuptuarit e esejes. Eseja e mestarisht e organizuar mirë. Shumica e ideve kanë radhitje logjike. Ka përputhje të kalimeve nga një pjesë në tjetrën.
2 pikë (pranueshëm)	Hasen shumë gabime drejtskrimore ose ka gabime gramatikore, që ndikojnë në të kuptuarit e esejes.
1 pikë (fillestar)	Drejtskrimi dhe gramatika janë zbatuar shumë dobët. Nxënësi përpiket, që t'i shpreh mendimet e tij gjatë shkrimit.

Nxënësi	Organizimi	Përmbajtja	Zbatimi i rregullave	Gjithsej

7. Fjalor

Koncepte: Kategori që përdoret për të grupuar ngjarje, ide, objekte ose njerëz. (Musai, 2003:417).

Konstruktivizëm: Tërësi doktrinash rreth të nxënësve, që thekson se njerëzit krijojnë ose ndërtojnë kuptimin nëpërmjet veprimeve zbuluese dhe interpretuese, veprimi për të kërkuar rrugë më të efektshme të mësimdhënies dhe të nxënësve. (Musai, 2003:417).

Krijimtaria: Aftësia për të prodhuar vepra që janë origjinale, të dobishme dhe të përshtatshme ndaj situatës aktuale. (Musai, 2003:24)

Motivim për të mësuar: prirja për t'i parë veprimtaritë mësimore të kuptimshme dhe të vlefshme dhe përpjekja për të përfituar prej tyre. (Musai, 2003:417).

Objektiva mësimore: Deklarim i qartë i materialit për të cilin synohet të mësohet. (Musai, 2003:417).

Organizues grafik: Mënyra e organizimit të mendimit në formë grafike. (Musai, 2003:417).

Përpunimi i informatës: Veprimtari e mendjes nejrëzore për të marrë informata, depozituar dhe përdorur informata. (Musai, 2003:417).

Pragmatik: Akti i të folurit dhe përdorimit të gjuhës në përshatshmëri me situatat, bashkëfolësin dhe kontekstet e ndryshme. Të shprehurit të jetë i kuptueshëm nga bashkëfolësi. Të shkruarit të jetë i kuptueshëm nga lexuesi.

Procesi i të shkruarit: Procesi ku shkruesit, amatorë dhe profesionistë, krijojnë kompozime.

Procesi përqendrohet në veprimtari të planifikuara ose në ide për të shkruarit. (Musai, 2003:417).

Pyetje divergjente: Pyetje që nuk kanë vetëm një përgjigje, por përgjigjet mund të jenë të ndryshme. (Musai, 2003:417).

Pyetje konvergjente: Pyetje që kanë vetëm një përgjigje të saktë.

Taksonomi: Sistem klasifikimi. (Musai, 2003:417).

Taksonomia e Bloomit: Sistem hierarkik i mendjes së niveleve të menduarit. Përbëhet nga gjashtë nivele: Përdoret për nivele të ndryshme të menduarit, që fillojnë nga niveli më i ulët deri në nivelin më të lartë të menduarit. (Musai, 2003:417).

Të nxënësve vëzhgues: Të mësosh duke vëzhguar dhe imituar të tjerët. (Musai, 2003:417).

Të nxënësve: Proces përmes të cilit përvoja krijon ndryshim të qëndrueshëm në njohuri dhe sjellje. (Musai, 2003:417).

Recensimi Për Librin

Autorja, Merita Banjica, në kuadër të librit *“Zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve të shkollave fillore”* jep një këndvështrim të hollësishëm mbi qasjen dhe zbatimin e metodave dhe mënyrave për nxitjen e të menduarit kritik dhe krijues tek nxënësve të shkollave fillore. Ky botim paraqet një kontribut të çmuar në fushën e pedagogjisë dhe didaktikës bashkëkohore, duke ofruar një qasje praktike dhe teorike për mësimdhënësve që synojnë tek nxënësve të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues përmes të shkruarit.

Ky botim do të shërbejë si mjet ndihmës për mësime të mësimdhënësve që dëshirojnë të përvetësojnë dhe zbatojnë metodologjinë konstruktiviste në mësime si dhe për nxënësve që synojnë të shkruajnë krijime të larmishme dhe të thella. Autorja e librit ka ndërtuar hulumtimin mbi tri objektiva kryesore: sqarimin teorik të mësimeve konstruktiviste dhe lidhjen e saj me zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues; paraqitjen e metodologjisë së hulumtimit të realizuar në Shkollën Fillore Komunale “Ismail Qemali” në Gostivar, Republika e Maqedonisë së Veriut; pasqyrimin e krijimeve të nxënësve të realizuara përmes shfrytëzimit të orientimit konstruktivist.

Libri është i strukturuar në tri pjesë të qarta: kapitulli i parë trajton bazën teorike, duke u mbështetur në mendimet e shkencëtarëve nga fusha e pedagogjisë, didaktikës dhe gjuhësisë; kapitulli i dytë paraqet metodologjinë e përdorur gjatë hulumtimit; ndërsa kapitulli i tretë sjell rezultatet e hulumtimit empirik me nxënësve, përfshirë shembuj konkretë të krijimeve të tyre të realizuara në periudhën katërvjeçare të punës intensive. Një aspekt veçanërisht i vlefshëm i këtij libri është ndërlidhja e teorisë me praktikën, duke dëshmuar se mësime konstruktiviste nuk është vetëm një koncept teorik, por mund të zbatohet me sukses në klasë për të nxitur kreativitetin dhe të menduarit e pavarur të nxënësve. Përmes këtij botimi, autorja synon të nxisë zhvillimin e shkathtësive së të shkruarit, por edhe dashurinë për leximin dhe të mësuarit aktiv.

Libri “*Zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve të shkollave fillore*” është një burim i domosdoshëm për çdo mësime që dëshiron të avancojë mësime të tilla dhe të drejtë një qasje më konstruktiviste dhe inovative. Ky botim përbën një udhërrëfyes të qartë për zhvillimin e të menduarit të lirë dhe krijues të brezave të rinj. Mësime mund ta përdorin këtë libër për të ndërtuar plane mësimore që i vënë nxënësve në qendër të së të nxënësve, duke i inkurajuar ata të shprehin idetë e tyre në mënyrë origjinale përmes esejave, tregimeve krijuese apo projekteve.

Gjithashtu, libri ofron modele konkrete të detyrave krijuese dhe strategjive motivuese që mund të aplikohen në klasë për të rritur interesimin dhe angazhimin e nxënësve në procesin e shkruarit.

Ky libër nxënësve u shërben si nxitje për të hulumtuar aftësitë e tyre krijuese dhe për të ndërtuar vetëbesimin në të shkruar, duke zhvilluar kështu edhe aftësitë për analizë dhe interpretim. Në trajnimet për mësime ose në programet e zhvillimit profesional, ky libër mund të përdoret si literaturë bazë për trajtimin e metodave konstruktiviste dhe për të ofruar ide praktike që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së të nxënësve në arsimin fillor.

Recensues: Prof.dr.Besa Dogani

Deklarata e konfliktit të interesit

Unë, Merita Banjica, mësime e lëndës “Gjuhë shqipe” në SHFK “ Ismail Qemali ”Gostivar në Republikën e Maqedonisë së Veriut deklaroj se ky studim i pasqyruar në këtë libër “ Zhvillimi i të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve të shkollave fillore” është punimi im origjinal, që pasqyron edhe krijime të nxënësve, të cilat i kanë krijuar gjatë orëve të gjuhës shqipe.

Sqarimi i koncepteve në kreun e parë është bërë nga burime të ndryshme si shfrytëzimi i literaturës shkencore pedagogjike, didaktike dhe gjuhësore, të cilat janë pasqyruar në listën e referencave në fund të librit të cituara në mënyrë të qartë. Mbledhja krijimeve të nxënësve është bërë gjatë tri viteve shkollore 2023-2024-2025, por në klasë të ndryshme për ta përcjellur përparimin e tyre gradual për të shkruarit e krijimeve.

Publikimi i punimeve të tyre në këtë libër është bërë me pajtueshmërinë e tyre sipas respektimit të Kodit Etik për të Drejtën e Autorit. Në fund të çdo krijimi qëndron e dhe emri i nxënësit.

Conflict of interest statement

I, Merita Banjica, teacher of the subject “Albanian Language” at the “Ismail Qemali” Primary School in Gostivar in the Republic of North Macedonia, declare that this study reflected in this book “Development of Critical and Creative Thinking in Primary School Students” is my original work, which also reflects the students’ creations, which they created during Albanian language classes. The clarification of the concepts in the first chapter was made from various sources such as the use of scientific pedagogical, didactic and linguistic literature, which are clearly cited in the list of references at the end of the book. The collection of students’ creations was done during the three school years 2023-2024-2025, but in different classes in order to follow their gradual progress in writing the creations. The publication of their works in this book is done with their compliance with the Code of Ethics for Copyright. At the end of each creation is the name of the student.

About the Author

Dr. Merita Banjica currently works in a primary school, but she never shied away from scientific research and participation in scientific conferences. She researches and writes about leadership and management in education, teaching and language. She is also a translator of the Macedonian language into the Albanian language.

Për autorin

Dr. Merita Banjica aktualisht punon në një shkollë fillore, por ajo asnjëherë nuk largua hulumtimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore. Ajo hulumton dhe shkruan për udhëheqjen dhe menaxhimin në arsim, mësimdhënien dhe gjuhën. Gjithashtu është edhe përkthyes e gjuhës maqedonase në gjuhën shqipe.

Merita i ka të publikuara disa libra dhe artikuj shkencorë në: Academia.edu, Globe.Edit, Knowledge, International Journal, Interligua, Centrum etj.

<https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/169>

<https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=954395>

<https://www.researchgate.net/publication/310804338>

<https://journals.indexcopernicus.com/api/file/viewByFileId/1145360>

<https://my.globeedit.com/catalog/index?layout=glutifag&page=189>

<https://www.walmart.com/ip/Q-ndrimi-i-drejtore-ve-ndaj-ndryshimeve-n-shkoll-2009-2010-Paperback-9786200619686/347765382>

<https://oapub.org/edu/index.php/ejfl/article/view/5934/8560>

<https://botimpex.com/index.php?p=liber&l=1914>
<http://konferenca.unishk.edu.al/icrae2014/cd/pdfdoc/578.pdf>
[https://library.carolinau.edu/eds?query=%22Creative%20thinking%22&type=DE&ff\[\]=Language:macedonian](https://library.carolinau.edu/eds?query=%22Creative%20thinking%22&type=DE&ff[]=Language:macedonian)
<https://journals.indexcopernicus.com/api/file/viewById/1145360>
<https://centrum.mk/wp-content/uploads/2023/12/PJESA-16.pdf>
<https://www.researchgate.net/publication/384216777>
<https://oapub.org/edu/index.php/ejfl/article/view/5888>
<https://oapub.org/edu/index.php/ejfl/article/view/5934/8560>

Referencat

1. Temple, Charls dhe të tjerët (2006). Strategji të mësimdhënies dhe të të nxënimit për klasat mendimtare, botuar nga The International Debate Education Association, Insitituti i Shoqërisë së Hapur (2005), Qendra pr Arsim Demokratik – CDE (2006), Tiranë dhe Qendra për Arsim të Kosovës-KEC, Prishtinë.
2. Jeff, Zwiers (2005). Zhvillimi i shprehive të të menduarit në shkollë në klasat 6-12, Manuel veprimtarish mësimore për intelegjencat e shumëfishta, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë dhe Qendra për Arsim të Kosovës, Prishtinë.
3. Musai, Bardhyl (2014) Metodologji e mësimdhënies –Arti dhe shkenca të përgatitur nga nxënës të suksesshëm, Qendra për Arsim Demokratik(CDE), Botimi i dytë ISBN: 978-99927-822-2-6, Tiranë.
4. Musai, Bardhyl (2009). Të shkruajmë objektivat mësimore për mësimdhënien dhe vlerësimin, CDE (QAD), Tiranë.
5. Musai, Bardhyl (2009). Si të shkruajmë ese, CDE (QAD), Tiranë.
6. Musai, Bardhyl (2004). Si të shkruajmë një punim shkencor, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.
7. Musai, Bardhyl (2005). Mësimdhënia dhe të nxënët ndërveprues-Modele për zhvillimin e të menduarit kritike të nxënësve -Shkencat shoqërore 6-12, Qendra për Arsim Demokratik (CDE) në Tiranë e ka të drejtën e licencuar për zbatimin në Shqipëri të projektit: Zvillimi i të Menduarit Kritik gjatë të Lexuarit dhe të Shkruarit (MKLSH) filluar nga 09.06.2003 nga International Reading Association (IRA), 800, Barksdale road, PO box 8139, Newark, DE 19714-8139, Tiranë.
8. Musai, Bardhyl (2005). Strategji të mësimdhënies dhe të nxënimit përklasat mendimtare, Qendra për Arsim Demokratik (CDE) -Tiranë dhe Qendra për arsim e kosovës-Prishtinë, e kanë të drejtën e licencuar të Projektit: Zvillimi i të Menduarit Kritik gjatë të Lexuarit dhe të Shkruarit (MKLSH), Tiranë -Prishtinë.
9. Murati, Xeladin (2024). Arsimi zbërthen në lëvizje, Litera Academy, Tetovë.
10. Murati, Xeladin (2024). Fuqia transformuese e arsimit, Litera Group, Shkup.
11. Murati, Xeladin (2024). Hyrje në Andragogji, Litera Academy, Tetovë.
12. Murati, Xeladin (2024). Për metodologjinë e kërkimit dhe kërkimet në arsim, Litera Group, Shkup.

13. Mustafa, Avzi (2002). Didaktika e gjuhës shqipe dhe leximit letrar, Shtëpia botuese Logos, Shkup.
14. Woolfolk, Anita (2011). Psikologji edukimi-Universiteti Shtetëror i Ohajës, Botuar nga Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë.
15. Zajazi, Tahir (2003). Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies-Didaktika, Vinsent Graphic, Shkup.

Doracakë

1. Mësimdhënia dhe mësimi në shekullin 21 (2009). Doracak për arsimtarët e arsimit fillor-Projekt i arsimit fillor, Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID Maqedoni dhe Akademia për Zhvillim të Arsimit –AED Maqedoni, Shkup.
2. Praktikum për mësimdhënie dhe mësimi në shekullin 21 (2010), Doracak për arsimtarët e arsimit fillor-Projekt i arsimit fillor, Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID Maqedoni dhe Akademia për Zhvillim të Arsimit –AED Maqedoni, Shkup.

Burime nga internet

1. Banjica, Merita (2020). The qualities of a modern teacher(Cilësitë e mësimdhënësit modern), botuar në "Education" - Journal of Educational Research of UT, më 28.02.2020 Vol.2 / No. 3-4 , ISSN 2671-3268, E-ISSN - 2671-3276, më 28.02.2020 në: <https://eprints.unite.edu.mk/579/1/3.pdf>
2. Banjica, Merita (2020). The approach on teaching writing a creation-essay (Qasja në mësimdhënien e të shkruarit të një krijimi-ese) botuar në knowledge – International Journal, Vol. 42 parë në: <https://ikm.mk/ojs/index.php/kij/article/view/5156>
3. Neel Burton, M.D. (2019). The Psychology and Philosophy of Memory, And 10 ways to improve your memory Article updated on 18 June 2019,parë më 09.02.2020: <https://www.psychologytoday.com/us/blog/hide-and-peek/201806/the-psychology-and-philosophy-memory>
4. Scott Jamison, MD, Left and Right Hemisphere of të brain, November 25, 2020 parë më 14.01.2021 në: <https://human-memory.net/left-and-right-hemisphere-of-the-brain/>
5. Graham Stanley, British Council, Barcelona (2019) Approaches to process writing, parë më 01.02.20120 në: <https://www.teachingenglish.org.uk/article/approaches-process-writing>
6. Richard Frost, British Council, Turkey (2019). Një qasje e bazuar në detyra <https://teachingenglish.org.uk/article/a-task-based-approach>
7. Edith Cowan University (2018). Written by Graham Stanley, British Council, Barcelona, Approaches to process writing pare në: <https://www.teachingenglish.org.uk/article/approaches-process-writing>

8. Alison Doyle (2019). Creative Thinking Definition, Skills, and Examples parë më 10.02.2018 në: <https://www.thebalancecareers.com/creative-thinking-definition-with-examples-2063744>
9. Mendimi Kritik dhe Kreativ (N.d.) (2018). parë më 01.02.2020 në: <https://www.australiancurriculum.edu.au/f-10->
10. Brookhart, S. (2010). Vlerësimi i krijimtarisë dhe të menduarit krijues. Si të vlerësoni aftësitë e të menduarit të rendit më të lartë tuaj në klasë (f. 124-141). SH.B.A.: ASCD.
11. Mendimi Kreativ VLERA Rubrika (2018). parë më 01.02.2020 në: <https://aacu.org/value/rubrics/creative-thinking>
12. Graham Stanley, British Council, Barcelona (2019). Approaches to process writing parë më 01.02.2020 në: <https://www.teachingenglish.org.uk/article/approaches-process-writing>
13. Edith Cowan University (2018). Centre for Learning and Teaching parë më 01.02.2020 në: https://intranet.ecu.edu.au/data/assets/pdf_file/0004/772249/creative-thinking.pdf
14. Association of American Colleges and Universities. (2009). Creative Thinking Value Rubric. Retrieved from, parë më 01.02.2020 në: <https://aacu.org/value/rubrics/creative-thinking>
15. Assessing creativity and creative thinking. In How to assess higher-order thinking skills in your classroom (pp. 124-141). US: ASCD. Critical and Creative Thinking. (n.d.) Retrieved February 10, 2018 from, parë më 01.02.2020 në: <https://www.australiancurriculum.edu.au/f-10-curriculum/general-capabilities/critical-and-creative-thinking/>
16. How to Teach Creative Writing Activities parë më 01.02.20120 në: <http://creativewriting-bg.com/assets/How-to-teach-creative-writing.pdf>
17. Christopher Taylor (March 29, 2019). How to teach creative writing parë më 04.02.2020 në: <https://wikihow.com/Teach-Creative-Writing>
18. Lewis, Beth (2020). Taksonomia e Bloom-it- mjet i mësimi të pabesueshëm, parë më 14.01.2021 në: <https://sq.eferrit.com/taksonomia-e-bloom-it-mjeti-i-mesimit-te-pabesueshem>
19. Moduli 1: Aspekte të të nxëniti. Metoda mësimore për mësimin praktik parë më 09.02.2020 në: <http://www.alledkosovo.com/publications/download/4-Trajnimi-i-m%C3%ABsimdh%C3%ABn%C3%ABsve/Modul-trajnimi-Didaktike.pdf>
20. Valbona, Imeraj (Taksonomia e rishikuar e Bloom-it parë më 12.04.2025 në: https://academia.edu/11234134/Taksonomia_e_rishikuar_e_BLOOM_it
21. Islam Karanfili - Dr. Zihni Osmani (Shkup, 2020). Gjuha shqipe dhe leximi për klasën IX /, Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup, Arbëria Design – Tetovë. parë më 13.04.2025 në: https://www.eucebnici.mon.gov.mk/pdf/Albanski_9_SREDENO%20ZA%20PECAT%20157x229_compressed.pdf
22. John Dewey për më 13.04.2025 në: https://sq.wikipedia.org/wiki/John_Dewey

23. M.A. Selver Bajgora (2019). Fushat e të nxënit parë më 13.04.2025 në: <https://selverbajgora.weebly.com/artikuj-pedagogjik/fushat-e-te-nxenit>
24. Të mësuarit ndërveprues konstruktivist në EQD/EDNJ për më 13.04.2025 : https://www.living-democracy.com/pdf/sq/V4/V04_OUTLINE.pdf
25. Bora Habili (2018). Konstruktivizmi në edukim parë më 21.04.2025 në: https://www.academia.edu/40467297/KONSTRUKTIVIZMI_N%C3%8B_EDUKIMI

Creative Commons licensing terms

Author(s) will retain the copyright of their published articles agreeing that a Creative Commons Attribution 4.0 International License (CC BY 4.0) terms will be applied to their work. Under the terms of this license, no permission is required from the author(s) or publisher for members of the community to copy, distribute, transmit or adapt the article content, providing a proper, prominent and unambiguous attribution to the authors in a manner that makes clear that the materials are being reused under permission of a Creative Commons License. Views, opinions, and conclusions expressed in this research article are views, opinions, and conclusions of the author(s). Open Access Publishing Group and European Journal of Foreign Language Teaching shall not be responsible or answerable for any loss, damage, or liability caused in relation to/arising out of conflicts of interest, copyright violations, and inappropriate or inaccurate use of any kind content related or integrated into the research work. All the published works are meeting the Open Access Publishing requirements and can be freely accessed, shared, modified, distributed, and used in educational, commercial, and non-commercial purposes under a [Creative Commons Attribution 4.0 International License \(CC BY 4.0\)](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/).